

# **Gjurmëve të Identitetit Egjiptian**

Përmbledhje e punimeve mbi etnogjenezën e  
Egjiptianeve në Ballkan, Opinione dhe Analiza mbi  
gjendjen e Egjiptianeve të Kosovës

Shtator, 2011

Përgatiti për botim: *Fazli Stollaj*

Përzgjedhja e materialeve: *Xhevdet Neziraj dhe Fazli Stollaj*

Sponsor: *IRDK*

Shtator, 2011

## Përmbajtja

Përmbledhje .....	1
Abstract.....	5
Historiku.....	9
Gjurmëve të Identitetit Egjiptian .....	11
Të dhëna shkencore lidhur me identitetin Egjiptian .....	11
Dr. Rubin Zemon .....	13
Te dhëna etnologjike, historike dhe arkeologjike për origjinën e Egjiptianeve në gadishullin Ballkanik .....	13
Luan Dino.....	19
Shpërnguljet e popullsive dhe “pasaporta” e tyre etnike.....	19
Prof. Dr. Skënder Riza.....	25
Me çfarë kuptimi përdoren emrat egjiptian, ashkalinj dhe rom?!.....	25
Dr. Muhamet Pirraku .....	29
Kush janë shqiptarët Egjiptianë Albanofonë?.....	29
Dr. Marcel Courthiade .....	35
Dr. Maliq Osi .....	37
Identiteti kombëtar të shqiptarëve egjiptas kosovar .....	37
Dr. Hakif Bajrami.....	45
Opinione dhe analiza mbi gjendjen e Egjiptianeve të Kosovës.....	47
Xhevdet Neziraj.....	49
Gjendja aktualeve e Egjiptianeve të Kosovës .....	49
Fazli Stollaj.....	51
Koha mund të na harroj për shkak të spontanitetit tonë.....	51
Imer Alijaj.....	53
Apel intelektualeve .....	53
Foto galeria.....	55



## Përmbledhje

Bashkësia etnike e Egjiptianeve në shtetet e Ballkanit gjatë periudhave të ndryshme në të kaluarën nuk është prezantuar në formë të organizuar në mbrojtjen e identitetit etnik deri në dekadën e fundit të shekullit XX, për shkak të zhvillimeve të tensionuara neper sistemet e ndryshme të shteteve të rajonit dhe më gjerë. Veprimtarët e kësaj bashkësie etnike punuan me zell gjatë dekadës së fundit të shekullit të kaluar. Edhe pas përfundimit të luftës në Kosovë vazhdoj veprimtaria e fokusuar në mbrojtjen e identitetit etnik, prandaj edhe ky libër që është përmbledhje punimesh mbi etnogjenezën e Egjiptianeve në Ballkan është vazhdimësi e punës për informimin e opinionit lidhur me etnogjenezën e egjiptianeve në Ballkan.

Historia tregon se popuj të ndryshëm nga vende të ndryshme janë copëtuar ose asimiluar në shkallë të ndryshme për shkak se gjatë periudhave të ndryshme grupe të ndryshme etnike e kanë braktisur atdheun e tyre për një jetë më të mirë ose për të mos renë nën sundimin e pushtuesve. Prandaj është vështirë të gjendet një vend me një bashkësi etnike të pastër në të gjitha kontinentet.

Egjiptianët të cilët jetojnë në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni dhe vende tjera të Ballkanit janë identifikuar me emërtime të ndryshme si: magjup, evgjit, ashkali, firaun dhe emërtime tjera. Qarqet akademike i kanë analizuar etimologjinë e këtyre emërtimeve dhe këto analiza tregojnë se këto emërtime ndërlidhen me vendin e origjinës së kësaj bashkësie etnike.

Kështu shkencëtarët e mëdhenj të gjuhës shqipe *Eqrem Qabej* dhe *Aleksander Xhuvani* shpjegojnë se parashtesa **Ma** i është ngjitur fjalës greke **Aougjptius** dhe është përfutur fjala *Magjup*.

Etnologu *Rubin Zemon* në punimet e tij prezencën e Egjiptianeve në Ballkan e ndërlihd duke sqaruar kolonizimin e Gadishullit Ballkanik nga Egjipti i vjetër në periudhën e faraonëve Seti I dhe Ramzesi II në të cilën periudhë rajoni i Ballkanit u kolonizua nga Egjipti me qëllim të eksploatimit të hekurit dhe mineraleve tjera fisnike. Përmes të dhënave mitologjike, historike dhe arkeologjike ky autor i shumë shkrimeve mbi etnogjenezën e Egjiptianeve të Ballkanit, tregon lidhjet e Ballkanit me Egjiptin e Lashtë në shumë pikëpamje, si konsekuenca të migrimit dhe kolonizimit të Egjiptiane në Gadishullin Ballkanik.

Studiuesi *Luan Dino* argumenton etnogjenezën nga Egjipti për evgjitetë në Shqipëri. Ai citon shumë dijetarë të mëdhenj të kulturës dhe shkencës shqiptare në veprat e tyre si *Sami Frashri* i cili në veprën e tij për Afrikën, Egjiptin e identifikon me emrin Evgjiteria (Misiri) dhe në veprën tjetër “Kamus ul- Alam” vërteton se në Shqipëri, Rumani, Turqi Europiane e Serbi ka, ku më shumë e ku më pak, evgjitetë. Studiuesi *Dino* përmend *Zija Shkodren* i cili në veprën “Esnafët shqiptarë” përshkruan përbërjen e popullsisë në qytetet shqiptare në mesjetë dhe në mes të popujve tjerë përmend edhe grupin e evgjitëve joshëtitës me prejardhje nga Egjipti. Ky studiues gjithashtu denoncon Enver Hoxhën në një vepër të tij që kishte shkruar se evgjitetë nuk janë me prejardhje nga Egjipti dhe me tej *Dino* në mënyrë shkencore argumenton shtrembërimet që kishte bërë Enver Hoxha.

Prof. *Skënder Riza* thekson se Egjiptianët e Shqipërisë Etnike (Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia) janë me prejardhje nga Egjipti. Gjuha e këtyre është shqipja prandaj quhen egjiptian shqiptar. Prezencën e Egjiptianeve në Ballkan ai e ndërlihd me Perandorinë e Pellazgeve, paraardhës të ilireve, të cilët e kishin zgjeruar sundimin e tyre deri në Afrikë e Azi dhe gjuha pellazgjishte si pasardhëse e gjuhës shqipe ishte gjuhë universale dhe popullore e komunikimit në këto pjesë të botës. Prof. *Riza* thekson se një numër pellazgë të Egjiptit, të cilët për arsye deri më sot të panjohura, janë shtrënguar të dynden në Siujdhesën Ballkanike, kanë ardhur këtu me gjuhën e tyre amtare pellazgjike – shqipe – egjiptiane. Këta të shpërngulur, në të vërtetë, kanë kaluar nga një trevë e Pellazgjisë në trevën tjetër të saj – në djepin e pellazgëve – në Gadishullin Ballkanik. Për këtë arsye, këta muhaxhirë janë quajtur, sipas atdheut të tyre të lashtë – magjupë ose gjupë, gjipë.

Prof. *Muhamet Pirraku* ndër të tjera thekson se rreshtimet etnokul-

turore politike aktuale shqiptarët Egjiptianë dhe shqiptarët hashkali janë shumë të ngjashme ose plotësisht identike dhe u përkasin ardhjes më të hershme se ardhja e gabeleve. Ato fillimisht u vendosen si kolonë e krah pune zejtar në fshatra me popullsi anëse, por edhe në qytete. Prof.Pirraku thekson se në Drenicë është i pranishëm koncepti magjup, por edhe pejorativi hashkali për ata që flasin vetëm shqip, ose për shqiptarët zeshkan. Në Rrafshin e Kosovës për këtë grupacion aktualisht dominon koncepti hashkali (varianti serbisht – ashkali). Në gegërishten e Kurbinit përmendën me antonimin gjysh, në viset të Iliriadës – janë konceptet gjips, gjipcë, në Toskëri është koncepti evgjitë, dhe në vise të Tiranës, koncepti jevgjit.

Dr. *Marsel Courthiade* thekson se në Evropë tani ngritët nocioni i minoriteteve pa territor kompakt. Jemi afro dhjetë minoritete të tilla në kontinentin tonë dhe Romët, Egjiptianët, Vllenjët, Laponët, Euro-amazigjet e Beashtet, për të përmendur vetëm disa prej tyre, bëjnë pjesë në këtë numër. A duhet të themi se të gjithë janë romë? Në asnjë mënyrë. Atëherë pse të thuhet se vetëm Romët, Egjiptianët e dy tre grupe tjera janë Romë? Vetëm për të ndjekur etiketimin që kanë bërë para disa shekujsh disa katunar analfabet në Perandorinë Bizantine. Duket qartë se kjo nuk është një burim shkencor prandaj është më e drejtë nga ana shkencore, si dhe nga ana njerëzore, që ta konsiderojmë Evropën me këtë koncept të minoriteteve pa territor kompakt ku ne jemi një pjesë e saj.

Këto që u përmenden më lartë janë disa thekse të studiuesve nga qarqet akademike të cilët përmes shkrimeve të tyre kanë hedhur dritë në etnogjenezen e Egjiptianëve të Ballkanit. Pjesa dërmuese e këtyre punimeve janë prezantuar në tribunën shkencore të organizuar në vitin 2003 nga Shoqata “Shqiptaro Egjiptiane” në të cilën kanë marrë pjesë Dr.Rubin Zemon, Prof.Skender Riza, Prof.Muhamet Pirraku, Prof.Hakif Bajrami, Akademik Mark Krasniqi, Akademik. Pajazit Nushi, Dr.Bujar Dugolli, Dr.Maliq Osi dhe personalitete tjera nga qarqet akademike..

Në këtë libër gjithashtu është dhënë një historik i shkurtër i Shoqatës “Shqiptaro Egjiptiane” dhe të partisë politike të Egjiptianëve të Kosovës, IRDK, dhe disa opinione të disa figurave politike dhe intelektuale të Egjiptianëve të Kosovës.

Fazli Stollaj





## Abstract

Egyptians ethnic community in the Balkan countries during different periods in the past is not presented in an organized manner to protect ethnic identity until the last decade of the twentieth century, because of the tense developments across different systems of countries in the region and beyond. These community activists worked diligently over the last decade of last century. Even after the war in Kosovo the activists had continue focusing on protection of ethnic identity, therefore this book which is a compilation of works on ethno genesis of Balkans Egyptians is continuation of the work for public information about the ethno genesis of Balkans Egyptian.

History shows that different peoples from different countries are chopped or assimilated to varying degrees because during different periods different ethnic groups have left their homeland for a better life or to not come under the rule of the invaders. It is therefore difficult to find a place with an ethnic community clean on all continents.

Egyptians living in Kosovo, Albania, Macedonia and other Balkan countries are identified with different names like: magjup, Evgjit, Ashkali, firaun and other designations. Academic circles have analyzed the etymology of these names and these tests show that these designations relate to the country of origin of this community. So the great scientists of the Albanian language *Eqrem Qabej* and *Alexander Xhuvani* prefix "Ma" explain the Greek word is adjacent to and acted Aougjiptius "Magjup" word.

Ethnologist *Rubin Zemon* his work in the presence of Egyptians in the Balkans links by explaining the colonization of the Balkan Peninsula by Ancient Egypt during pharaohs Seti I and Ramzesi II period in which the Balkan region was colonized by Egypt in order to exploit iron and other precious minerals. Through mythological, historical and archaeological data this author in many articles on ethnic background of Balkan Egyptians shows links with ancient Egypt in many respects, as consequences of migration and colonization of the Egyptian in the Balkan Peninsula.

Researcher *Luan Dino* argues ethnic background of “evgjit” from Egypt for evgjit’s of Albania. He cites many great of Albanian scholars’ culture and science in their works as *Sami Frasheri* who in his work for Africa, Egypt is identified by name Evgjiteria (Misiri) and other work ‘Kamus al-Alam’ confirms that in Albania, Romania, European Turkey and Serbia, where more where less has evgjit. Dino mentions that researcher *Zija Shkodra* in the work “Albanian Craftsman” describes the composition of the Albanian population in cities in the feudalism and among other peoples mentioned the Egyptians as no nomad group originating from Egypt. The researchers Dino also report the Enver Hoxha in his work which he had written that evgjit are not originally from Egypt and beyond in scientific way Dino argues distortions that Enver Hoxha did.

Prophesor *Skender Riza* states that Egyptians of Ethnic Albania (Albania, Kosovo and Macedonia) are originally from Egypt. The language of these is Albanian so called Egyptian Albanian. Presence of Egyptians in the Balkans, he connects with the Pelasgians empire, ancestor of the Illyrians, who had extended their rule to Africa and Asia and pelasgian language as the successor of the Albanian language was universal and popular language of communication in these parts of the world. Prof.*Riza* notes that a number of Egypt Pelasgians, who for unknown reasons to date, are forced to flock to the Balkan Peninsula, have come here with their mother tongue Pelasgian - Albanian - Egyptian. These displaced, in fact, have gone from a territory of the other Pellazgian region in her - the cradle of the Pelasgians - in the Balkan Peninsula. For this reason, these are called mohair according to their ancient homeland - or “gjuhë, magjupë, gjipë”.

Prophesor *Muhammad Pirraku* among that ethno-cultural, political alignment of Albanian Egyptians and Albanians hashkali are very similar or completely identical and belong earliest arrival that the Roma’s. They were initially set as the colons and labor in villages with

craftsman side populations, but also in cities. Professor Pirraku states that in Drenica "magjup" and "hashkali" concept is present for those who only speak Albanian or for brown Albanian. In the area of Kosovo that currently dominates the concept hashkali (Serbian version - Ashkali). In Gheg Kurbin cited with Grandpa in the Iliriada areas - are concepts Gypsum, gjipcë in Toska is evgjit concept, and in areas of Tirana, the concept of "evgjit".

Dr. *Marcel Courthiade* states in Europe now raised the notion of minorities without compact territory. There are about ten such minorities in our continent the Roma, Egyptians, Vllahs, Laponons, Euro-amazighet of Beashet, to name just a few of them. Do we have to say that all are Roma? No way. Then why we say that only Roma, Egyptians and two to three other groups are Roma? Just follow the ethicists that made a few centuries before some illiterate peasant in the Byzantine Empire. Obviously this is not a scientific source is therefore right from the scientific as well as humanly, to consider the concept of Europe with minorities without compact territory where we are a part of it.

Those that were mentioned above are some of the emphasis from academic researchers who through their writings has shed light on to the Balkans Egyptians ethnic background. The majority of these works are presented in scientifically tribune organized in 2003 by the "Albanian-Egyptian" Association in which has participated Dr. Rubin Zemon, Professor Skender Riza, Professor. Muhamet Pirraku, Professor. Hakif Bajrami, Academic Mark Krasniqi, Academic. Pajazit Nushi, Dr. Bujar Dugolli, Dr. Maliq Osi and other personalities from academic circle.

In this book also provides a brief history of the "Albanian Egyptian" Association and the political party of Kosovo Egyptians IRDK and some opinions of some political and intellectual figures of the Kosovo Egyptians.

Fazli Stollaj



## Historiku

Partia Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës, IRDK themelohet në një kohë të rëndësishme të historisë sonë, si vazhdimësi e Shoqatës “Shqiptaro – Egjiptiane “ e Kosovës.

Pas vendosjes së forcave ndërkombëtare, fillimit të organizimit dhe të ndërtimit të institucioneve të para demokratike të Kosovës, u krijuan kushtet e përshtatshme për veprimtari politike dhe organizimin e komunitetit tonë në subjekt politik.

IRDK është parti me orientim Evropian që synon afirmimin dhe sendërtimin e shoqërisë moderne dhe të sistemit demokratik në Kosovë sipas modelit tashmë të sprovuar të demokracisë evropiane. Në Këshillin iniciues për formimin e IRDK-së ishin:

- |                                   |                         |
|-----------------------------------|-------------------------|
| - Ing.Dip. <i>Emin Sefa</i>       | - <i>Hasan Kersh</i>    |
| - Ing.Dip. <i>Imer Alijaj</i>     | - <i>Zymer Krasniqi</i> |
| - <i>Ibish Bajrami</i>            | - <i>Bedri Mustafa</i>  |
| - <i>Beslim Hoti</i>              | - <i>Qelë Neziri</i>    |
| - Dr. <i>Avdullah Qafani</i>      | - <i>Sami Radi</i>      |
| - Ecc.Dip. <i>Xhevdet Neziraj</i> | - <i>Vllaznim Saku</i>  |
| - Ing.Dip. <i>Fazli Stolaj</i>    | - <i>Muhamet Salih</i>  |
| - <i>Xhevahire Shala</i>          | - <i>Naser Kongjeli</i> |
| - <i>Kumrie Bajrami</i>           | - <i>Isuf Sadiku</i>    |
| - <i>Muhamet Maleshi</i>          |                         |
| - Ecc.Dip. <i>Nazif Fetahu</i>    |                         |
| - <i>Gazmend Dervoishi</i>        |                         |
| - <i>Ramë Berisha</i>             |                         |
| - <i>Qamil Hoti</i>               |                         |

dhe shumë veprimtarë të tjerë.

IRDK u themelua në mars 2001, mbi përvojat e ndryshme dis-avjeçare të Partive Politike, të lëvizjeve dhe të individëve të dëshmuar me një të kaluar patriotike në rrafshin kombëtar, politik, ushtarak e shkencor.

Kuvendi Parë zgjedhor te mbajtur ne Prill 2002, u zgjodh Kryesia dhe Kryetari, në ç' rast kryetar u zgjodh Bislim Hoti.

Kuvendi i dytë Zgjedhor u mbajt ne vitin 2004 dhe u rizgjodh z.Bislim Hoti Kryetar i IRDK – së, ndërsa Kuvendi i tretë u mbaj në vitin 2006 dhe Kryetar u zgjodh z.Xhevdet Neziraj.

IRDK e ka dëshmuar veten si pjesë e institucioneve të Kosovës qe nga themelimi i tyre gjerë me sot. Në mandatin e pare të institucioneve kosovare te pasluftës në Kosovë, IRDK- ja mori pjesë në Parlamentin e Kosovës me dy deputet dhe ishte ne grupin parlamentar me AAK. Po ashtu në zgjedhjet e dyta Parlamentare IRDK mori pjesë me dy deputet dhe prapë ishte ne grupin Parlamentar me AAK dhe me një Zëvendës ministër ne Qeverinë e Kosovës.

Në dy mandatet Deputet ishin z.Beslim Hoti dhe z.Xhevdet Neziraj, ndërsa Zëvendës ministër ne Ministrin e Kthimit ishte z.Ibish Bajrami. IRDK gjithashtu në rrafshin lokal ka dy nënkryetar Komunash ku në Gjakovë përveç dy deputeteve edhe Nënkryetari i dyte ka qenë nga radhët e IRDK- së z.Zija Rugova, ndërsa ne Komunën e Istogut Nënkryetari i Dytë ishte Ing.Dip.Fazli Stollaj, po ashtu ne komunën e Pejës ishim te përfaqësuar me deputet në Asamble Komunale. Në disa komuna si në Pejë, Gjakovë,Istog kemi te punësuar edhe në Zyrat për Komunitete si dhe pjesëmarrje në Komitete të ndryshme te formuar pranë Asambleve Komunale. Degët e IRDK- së janë në këto qytete Gjakovë, Pejë, Istog, Prizren, Klinë ,Deçan dhe F.Kosovë..

Gjithashtu dy deputet në Parlamentin e Kosovës ishin të përfshirë në komisione Parlamentare dhe ishin anëtar të Këshillit Konsultativ për Komunitete. IRDK, përmes kryetarit të saj dhe deputetit të Parlamentit të Kosovës është nënshkruese e Deklaratës së pavarësisë së Kosovës. IRDK gjithashtu është përfaqësuar në Komisionin për hartimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

IRDK përfaqëson shpresën dhe alternativën me te mire për qytetaret e komunitetit egjiptian ne pajtim me parimet e demokracisë euro perëndimore,duke çmuar respektuar paqen dhe lirinë për të gjithë.

IRDK angazhohet për krijimin e paqes dhe te marrëdhënieve te mira në mes të qytetarëve të Kosovës. Vetëm në rrethana te këtilla, ku çdo qytetar është i sigurt dhe e ka te sigurt pronën,krijohen kushte për përparim ekonomik të Kosovës.

# **Gjurmëve të Identitetit Egjiptian**

**Të dhëna shkencore lidhur me identitetin Egjiptian**





## **Dr. Rubin Zemon**

### **Te dhëna etnologjike, historike dhe arkeologjike për origjinën e Egjiptianeve në gadishullin Ballkanik**

Problematika e datimit dhe përcaktimit të migrimit të popullatës prej Egjiptit në Ballkan është shumë komplekse dhe aksesit të problematikat duhet të jetë multidisiplinare me ndihmën e shkencave të ndryshëm.

Deri në mesin e mijëvjeçarit të dytë p.e.s. në Mediteranin lindor shteti dhe civilizimi i Egjiptit të lashtë ka qene fuqia me e madhe dhe me influente[1]<sup>1</sup>. Prej shekullit të XII p.e.s. përdorimi i bronzit në ekonominë e atjeshme po fillon të shkëmbehet me përdorimin e hekurit. Fillimi i periudhës së hekurit dhe “revolucioni i hekurit” periodikisht përputhet me sundimin e ashtuquajtur Dinastia e XIX në Egjipt, ose me faraonët Seti I (1294-1279 p.e.s.) dhe Ramzesi II (1279- 1213 p.e.s.)[2]. Duke parë nevojën për përdorim sa me të madhe të hekurit, këta faraonë filluan të importojnë hekurin në Egjipt prej vendeve të afërme, por dhe prej vendeve me të largëta, siç janë Anadolija, Gadishulli Ballkanik, Gadishulli i Apenineve, Kipari, Peloponezi etj., sepse sipas të dhënave historike nuk mund të shihet se ka qene e njohur prezenca dhe me atë eksploatimi i hekurit në territorin të Egjiptit, deri në periudhën e Ptolomejeve në Egjipt[3].

Revolucioni i hekurit, kërkimi i rezervave dhe eksportimi i minier-

ave te hekurit, sigurisht është shkaku që faraoni Ramzesi II do të jepet në sundim te bregdetit lindor të Mediteranit, Anadolisë dhe Gadishullit Ballkanik, për të cilat sundime vërtetim mund të gjejmë te Herodoti, i cili shkruan[4]: “ Do të mbahem te ai që ka qene mbret mbas tyre, i quajtur Sesostrit[5]...Kur do të përballëshit me ata te cilat me gjithë forcat do ta mbronin lirinë, në vendet e tyre vendoste shtylla me shkrim në te cilën do ta vinte emrin e tij dhe origjinën dhe se ata janë të sunduar prej ushtrisë se tij...Duke bërë këtë, kaloi në gjithë tokën, deri sa prej Azisë nuk u hodh në Evropë, dhe i sundoi Skitet dhe Traket. Mendoj se ata janë vendet me te largëta deri ku ka arritur ushtria Egjiptiane. Nuk mund te tregoj me siguri se vet mbreti Sesostrid ndante pjesë prej trupave te tij dhe atje i vendoste të vendbanohen, ose disa prej ushtareve janë mërzhitur prej sundimeve, dhe mbeten...”

Prej këtij citati te Herodotit vjen konkluzioni se në kohën te sundimit te Ramzesit II, në Gadishullin Ballkanik, erdhën dhe janë vendbanuar Egjiptianet. Duke marre parasysh se behet fjalë për një sundim me qellim që të eksploatohet hekuri dhe mineralet e tjera të Ballkanik, sigurisht bëhet fjalë për njerëz që kanë punuar me metalin. Për këtë mund të gjejmë dhe një vërtetim te Herodoti i cili tregon[6<sup>2</sup>]: “...Në Maqedoni ala Fenikjanet të lashtë e eksploatonin floririn prej minierave, te cilin e shkrinin në furra speciale, shumë para se te vijnë kolonistet Egjiptian në Helade...”. Prej këtij teksti shihet se Egjiptianet e kanë kolonizuar Gadishullin Ballkanik para rrojtjes te Herodotit. Prej gjithë këtyre shkrimeve të Herodotit, të cilat disa tjera do ti përmendim dhe me poshtë, mund te bëjmë një vlerësim se Egjiptianët në Ballkan janë vendbanuar për nevojën e eksploatimit të hekurit si dhe mineralet dhe metalet të tjera, fisnike të hekurit, dhe ata gjenden në vendet ku eksploatohet, përpunohet dhe shfrytëzohet hekuri, floriri dhe metalet e tjera.

Kolonizimi i Egjiptianeve të lashtë në Ballkan nuk mund të mos këtë influencën e saj në kulturën dhe civilizimin e popullatës që jetonte në atë kohe në Ballkan. Duke pas sysh faktin se bëhet fjalë për periudhë për të cilën nuk ka shumë të dhëna historike, disa konkluzione, siç është edhe për komunitetet e tjera, mund të sillen nëpërmjet legjendave dhe mitologjisë të popullatës Ballkanike, për të cilat kanë mbetur shkrime të historiografive.

Herodoti në librin e dytë Euterpa, në numrin 50 do të shkruajë: “Me në fund, emrat e afërsisht të gjithë perandorëve të Heladës kanë ardhur nga Egjipti”. Mandej, sipas shkrimeve të tij dhe sipas mitit te Persejit, na tregon[7]: “...Në qoftë se i emërojmë stërgjyshërit të Danaji [8], bija e Akrisijit, në qoftë se me origjinën shkojmë edhe me lashte, liderët Dorijan

[9] do të dalin Egjiptianë të vërtetë. Ajo, është origjina e mbretërve Spartijan, sipas Heleneve...". E njëjta është edhe sipas Persianeve, na tregon Herodoti: "Por, sipas asaj që e tregojnë Persianet, Perseji i cili ka qenë Asirijan, është bërë Helen. Por stërgjyshërit e Persejit, nuk kanë qenë Helene, të cilat kur bëhet fjalë për fis, nuk kanë asnjë me Persejin, por siç qe tregojnë dhe Helenet, ata qenkan Egjiptianë".

Miti ose legjenda tjetër e cila mund të sillet në lidhje me vendbanimin e Egjiptianëve në Ballkan është legjenda e Kadmos dhe Kadmejet e tij[10]. Sipas legjendës Kadmoa është Fenikijan, vëlla i Evropës e cila është e rrëmbyer prej Zeusit. Kadmoja shkon ta gjejë Evropën, dhe sipas legjendës, ai në fillim e kërkon në Krete, pastaj në Helade dhe nëpërmjet Lihnidit (Ohrit) shkon deri në bregdetin lindor të Adriatikut. Legjenda e Kadmos dhe Kadmejet e tij e lidhin tokën Egjiptiane (Teba në Nil), me Teben në Beoti dhe në fund me Teben në bregdetin Adriatik (sot Tivari). Shumë emra të stërgjysheve të Kadmos janë të njëjtë me emrat të njëjtë të vendeve dhe emrave historike: Epafi, bir i Ia-se i Zeusit, është i martuar për Memfisën, bija e Nilit. Këtyre i është lindur bija me emër Libija (emër greke për Afrikën). Libija ka qenë gjyshe e Kadmos, Evropës dhe Belit. Beli ka qenë babai i Danajes (Helades) dhe Ajgipes (Egjyptit). Njëri prej djemve të Kadmos quhet Ilir.

Aty mund të lidhën dhe shumë kontekste të tjera në legjendën e Kadmos dhe gruas se tij Harmonija, transformimi i tyre në formë të gjarprit, lidhja e Kadmos me Enhelejet ("Enhalon" emri i lashtë i qytetit të Strugës, në përkthim është "ngjalë"), i të cilave simbol i fisit ka qenë gjarpri. Nëpërmjet transformimit të Zeusit në bual (buali Apis është një prej perënditë me të respektuar në Egjiptin e Lashtë) dhe lidhja reminiscente me perëndinë-gjarpër të Egjiptit e quajtur Uazit, mund të shkohet ekoja dhe fuqia e civilizimit të Egjiptit, në mitin dhe legjendën të Kadmos dhe me atë të indikohen disa migracione të Egjiptianëve në Ballkan.

Legjenda e Kadmos mund të hyjë në një kontekst arkeologjik me disa të dhëna të varrezave në pjesën arkaikë të nekropoles "Trebenishtë" në f. Gorenci, afër Ohrit (shekulli VI-V p.e.s.). Fakti se maskat prej floriri dhe gjithë mbështillja prej floriri që i rrethon princat e vdekur në Mikene (Peloponez), ka reflektim reminiscesor të shfaqja e ngjashme në varrezat e princave të Trebenishtes, është sidomos në lidhje motive, se ky princip jo-helen, dhe me në fund princip egjiptian, i takon rrethit të njëjtë ideologjik dhe fetar si piramidave dhe mumifikimit. Në Egjipt, në Krete, në Miken dhe në Trebenisht, mund të shikojmë koncept të njëjtë të eskatologjise, që është i panjohur për shpirtin racional helenik[11].

Sipas Herodotit, bija e Kadmos, Semela është nëna e perëndisë së

Dionisit[12]. Treguam me lartë se Ramzesi II ka arritur deri te Skitet dhe Traket. Kulti i Dinosit në Ballkan zgjerohet prej Trakije[13]. Mënyra si festohet Dionisi, fabula dhe mesazhi i ceremonialit, vdekja e perëndisë dhe ringjallja e tij, është e ngjashme ose me mirë t themi e njëjta si legjenda e perëndisë te Ozirisit[14]. Si të parin që e ka sjellë kultin e Dionisit në Ballkan, Herodoti e përmenden Melanpodin, bir i Amiteonit[15]. Ai është i pari i cili Heleneve ja ka treguar emrin e Dionisit, kurbanin dhe processionin me faustin. “Por, më shumë besoj se Melanpodi e ka mësuar atë kult te Dionisit prej Kadmos, prej Tirit dhe prej atyre që erdhën me atë prej Fenikije në tokën që e ka emrin Beoti”. E përmendem Dionisin, se kulti i tij, ose mesazhi për ringjalljen e perëndisë te Ozirisit, sot akoma jeton te thujse te gjithë komunitetet në Ballkan, neper mjet ritualeve dhe adeteve të ndryshme, me qellim që të sigurohet mbrojtje, reproduksion dhe prosperitete te komunitetit.

Sipas disa autoreve dhe emri i vendit, termi gjeografik Maqedoni vjen nga Egjipti. Sipas, Diodorit nga Sicilija (historian i shekullit I p.s.e.) biri i Ozirisit e ka emrin Maqedon, i cili është lindur kur Ozirisi i ka sunduar këto troje[16]. Ai e ka lënë birin e tij të mbretërojë në këtë vend, dhe prandaj vendi quhet Maqedoni dhe banoret Maqedonas. Qe te kemi një spektër me të gjerë për këto tregime te Diodorit, duhet te kemi parasysh se Diodori perëndinë te Dijelit- Amon e quante Oziris[17]. Në mitologjinë Egjiptiane, faraonët sidomos ata te Dinastisë së XIX, qenkan trashëgimtarë direkt të Amonit, në tokë [18]. Prej kësaj mund të hipotekojmë se sundimet të Ramzesit II, kane refleksion dhe influencë edhe te legjendat dhe tregimet e Diodorit, për origjinën e emrit Maqedoni. Për më shumë, ka edhe një legjendë e shkruar prej Plutarhit[19], se Aleksandri i Madh i Maqedonisë nuk është biri i Filipit II, por i Nehtenahut, faraoni i fundit i Egjiptit nëpërmjet kujt perandoria Amon e ka bërë shtatzënë Olimpijen, nënën e Aleksandërit[20].

\* \* \*

Këto janë vetëm disa prej të dhëna mitologjike, historike dhe arkeologjike të cilat na tregojnë se lidhjet e Ballkanit me Egjiptin e lashtë janë të shumta në çdo pikëpamje, si konsekuenca të migrimit dhe kolonizimit të popullatës Egjiptiane në Gadishullin Ballkanik.

## Bibliografia:

1. "Egypt- from 3200 BC till present day", Tableaux Synoptiques De L'Historiere (TSH), Francë
2. Leonard Cottrel, *Is~eznatite Faraoni ( The Lost Pharaohs)*, Mislra, Skopje, 1988.
3. Bernd Scheel, *Egyptian Metalworking and Tools*, Shire Publications LTD, UK, 1989
4. Herodot, *Historija*, (Herodotova Istorija, Zumpres, Skopje, 1998), po ashtu *Historija e Herodotit mund te gjendet ne Internet faqen te : The Internet Classics Archive Browse.*
5. M. Konstantinov, *Makedonci*, Maring, Skopje, 1992.
6. H.S. Robinson- K.Wilson, *Mitovi i legende svih naroda*, Beograd, 1976, 167; John Pinsent, *Greek Mythology*, London, 1969.
7. Zdrù'enie na Egipjanite vo Makedonija, *Zbornik na trudovi za etnogezeta na Egipcianite vo Makedonija*, Skopje, 1996.
8. Pasko Kuzman, *Arheološki tragi za Egipcianite vo jugozapadna Makedonija*, ZbTEEM, Skopje, 1996, 167-178.
9. James George Frazer, *Zlatna Grana (The Golden Bough)*, Beograd, 1992.
10. Dragoslav Srejoivic & Aleksandrina Cermanovic, *Recnik Grcke i Rimski mitologije*, Beograd, 1979, 243.
11. Michael Rice, *Who is who in Ancient Egypt*, Routledge, London & New York, 1999, XXXIX.
12. Plutarh, *Aleksandar Makedonski*, Detska Radost, Skopje, 1994.

-----  
[1] "Egypt- from 3200 BC till present day", Tableaux Synoptiques De L'Historiere (TSH), France

[2] Leonard Cottrel, *The Lost Pharaohs*, 31

[3] Bernd Scheel, *Egyptian Metalworking and Tools*, 17

[4] Herodot, *Historia*, Libri i dytë i quajtur Euterpa, 102, 103

[5] Ramzesi II prej Heleneve është quajtur Sesostrit

[6] M. Konstantinov, *Makedonci*, 317

[7] Herodoti, Libri i Gjashtë i quajtur Erato, 53 dhe 54.

[8] Danaji është figurë mitologjike, bir i Belit, vëlla binjak i Ajgipit (Egjiptit) e ka krijuar Argun ne Peloponez.

[9] Dorijanet janë banorët kryesor të Peloponezitetit, Kretës dhe shumë vendbanime në Sicili dhe Apeninet e jugut.

[10] H.S. Robinson- K.Wilson, *Mitovi i legende svih naroda*, Beograd, 1976, 167; John Pinsent, *Greek Mythology*, London, 1969, 48

[11] Pasko Kuzman, *Arheološki tragi za Egipcianite vo jugozapadna Makedonija*, ZbTEEM, 167-178.

[12] Herodoti, II/145

[13] J.G. Freizer, *Zlatna Grana*, 488

[14] J.G. Freizer, 485-494

[15] Herodoti, II/49

[16] Dragoslav Srejoivic & Aleksandrina Cermanovic, *Recnik Grcke i Rimski mitologije*, Beograd, 1979, 243.

[17] J.G. Freizer, *Zlatna Grana*, 485

[18] Michael Rice, *Who is who in Ancient Egypt*, Routledge, London & New York, 1999, XXXIX.

[19] Plutarh, *Aleksandar Makedonski*, Detska Radost, Skopje, 1994, 7.

[20] Michael Rice, *Who is who in Ancient Egypt*, 143, 128



## Luan Dino

### Shpërnguljet e popullsive dhe “pasaporta” e tyre etnike

Historia e popujve të botës është histori luftërash e përpjekjesh të pareshtura për liri, pavarësi e përparim shoqëror. Ajo tregon se popujt e vendeve të ndryshme janë coptuar ose asimiluar në shkallë të ndryshme. Ajo tregon se, në rrjedhë të shekujve, grupe të mëdha nga popujt të ndryshëm kanë braktisur atdheun e tyre për një jetë më të mirë, ose për të mos rënë nën sundimin e pushtuesit. Për këtë arsye sot nuk mund të gjendet një komb i pastër, i papërzier me njerëz të tjerë: as në kontinentin amerikan, ku shihet përzjerja, kryqëzimi dhe bashkëjetesa e kombësive dhe racave njerëzore, as në Afrikë e Australi apo Azi, kurse në Evropën plakë kryqëzimet dhe përzjerjet vijnë që nga antikiteti.

Grupet e ndryshme shoqërore, kudo që kane shkuar e kudo që kanë ngritur “folenë” e tyre, kanë marrë me vete “pasaportën” e identitetit të tyre etnik, “pasaportë” që është ruajtur në shekuj në gjuhë ose në kulturën e tyre, qoftë edhe në një fjalë të vetme. Le të sjellim disa shembuj të

tillë: Ebrejtë, të shpërngulur nga Izraeli në shek.11 para erës së re si dhe më vonë, pas luftes se viti 69 të erës së re kundër Romës, e humbën gjuhën e tyre, ibriten, edhe sot “më shume se 13 milion flasin në gjuhë të ndryshme të familjes indoeuropiane;... grupe të veçanta ebrejsh, kryesisht në vendet e Ulta, Greqi dhe Turqi, te vajtur atje nga Spanja, pjesërisht kanë ruajtur ende gjuhën spanjolle, megjithatë masa kryesore e ebrejve kaluan në gjuhën e popujve, qe i rrethonin: angleze, gjermane, franceze, spanjolle, ruse, polake, ukrainase, persiane etj.1) “Megjithatë, ata i shoqëronte kudo pasaporta etnike “ebrej”, “Izraelit”, që do të thotë banor i vendit me emrin IZRAEL. Territorin e tyre etnik fillestar e kanë humbur edhe grupe banorësh të krahinës së VLLAHISË, e cila u dha atyre pasaportën etnike: vllah, arumun. Fjala “arberesh” dhe “ARVANIT” lidhen me grupe te caktuara nga asnjë vend tjetër veç nga ARBERIA, kur pas vdekjes së Skenderbeut, masa të tëra braktisën atdheun e tyre për të mos rënë nën sundimin e turqve. Fjala “arberesh” dhe fjala “arvanir” janë “pasaportë” etnike që ua dha ATDHEU i tyre.

Një shembull tjetër i humbjes së teritorit fillestar etnik mund të shërbejnë romët pasardhësit e emigrantëve nga India Veriore, te cilët në shekullin e katërmëdhjetë arritën në EUROPE permes ASISË së Vogël në Gadishullin e Ballkanit dhe përmes Afrikës Veriore kaluan në Spanjë”.2) Shembuj të tjerë të ngjashëm historia sjell në çdo kohe, por ne do te ndalemi gjerësisht tek grupi shoqëror që në Shqipëri njihet me emrin “EVGITIT”

Në gjuhën shqipe deri më sot nuk ka asnjë vepër të plotë ose punim te veçantë me objekt studimi prejardhjen etnike, kulturën, mënyrën e jetës, gjuhen e zakonet etj. të këtij grupi shoqëror. Heshtja dhe qëndrimi indiferent rreth tij, si edhe koha shumë e lashtë e shtegtimit nga territori etnik fillestar, kanë sjellë mjaft pështjellime dhe mendime kontraktore rreth këtij grupi, në mënyrë të veçantë rreth prejardhjes së tyre. Vetëm në disa punime dhe në mënyrë anësore hidhet dritë nga autorë të ndryshëm për, origjinën, profesionet, karakteristikat e këtij grupi shoqëror. Nga një krahasim i tyre rreth çështjes kryesore mbi origjinën, prejardhjen e kohës së shpërnguljes, del se autorët herë paraqiten të një mendimi, herë kanë mendime të ndryshme, siç do t’i shohim më poshtë në këtë punim. Ne do t’u japim një buzëqeshje gjithë atyre mendimeve qe evgjitët i paraqitin me prejardhje nga India Veriore, si një shtresë më e lashtë e romëve, e shpërngulur në kohë më lashtë. Historia nuk njih një



rast të tillë dhe nuk ka asnjë bazë, qëndrimet subjektive dëmtojnë të vërtetën historike.

Grupi shoqëror i egjiptianëve të Shqipërisë, një ndër grupet më të mëdha shoqërore, është emërtuar dhe thirret me këta emra: evgjit, jevg, magjyp dhe firaun, të cilët, në shqiptimin e përditshëm shoqërohen me një ngarkesë emocionale tejet përbuzëse, si një grup i një "race inferiore", 3) Lind me të drejte pyetja: Ç'kuptim kanë këto emërtime? Me cilin territor etnik lidhen ato? A ka lidhje midis vetë këtyre emërtimeve? Cila është shtrirja gjeografike e përdorimit të tyre?

Përgjigjen e këtyre pyetjeve e japin dijetarët më të mëdhenj të kulturës dhe shkencës Shqiptare në veprat e tyre. Ne do t'i renditim ato me radhë: Enciklopedisti i madh shqiptar SAMI FRASHERI shkruan në veprën e tij për Afrikën: Anët e ndahen në tri: 1 . Anët e botës, që atje është Evgjiteria (Misiri) edhe Berberia.4) Banorët e këtij vendi i ai i quan evgjitë: "... kështu kanë lindur shkronjat e persëve (axhemëvet) të vjetër, të israilinjët, të syrianevët, të arabevët, të evgjitëvet (të egjiptianëve) edhe me të vjetra të Hindit e të Çinjt'5) Dhe më tej ai shprehet: "Përpara shkruarja ka dale nd'Asi e nd'Afrikë. Po ato të shkruarat e asaj kohe s' ngjajnë me gjeakafshë, për të shkruarë një zë, beninë fytyrën e një gjëje të gjallë e të një gjëje tjetër. Kështu janë shkronjëzat e evgjitëve të vjetër (të kyptinjet) e të tjera."6)

Sami Frashëri është një njohës i thellë i popujve të Ballkanit dhe i grupeve të ndryshme shoqërore. Duke përshtuar popullsinë e çdo vendi ballkanik, ai tregon se në to banojnë edhe vlllehë, judhenjë, cergëtarë dhe evgjitë. Autor i veprës "Kamus ul- Alam" vërteton se në Shqipëri7). Rumani,8) Turqi Europiane9) e Sërbi10) ka, ku më shumë e ku më pak, evgjitë. Siç shihet, për dijetarin e madh Sami Frashëri evgjitët vijnë nga shteti i lashtë i Egjiptit, të cilin ai e emërton EVGJITERI (MISIR). Dy dijetarët e rëndhenj të gjuhës shqipe Prof. Dr. Aleksander Xhuvani dhe Eqrem Qabej shpjegojnë formimin e fjalës Magjyp në gjuhën shqipe: "parashtesa ma- i është ngjitur temës Aogjyptius, greqishte e re dhe është përftuar fjala magjyp. Në fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe12) lexuesi gjen këtë shpjegim për fjalën evgjit: "Pjestar i një grupi banoresh të disa qyteteve të vendit tonë e të vendeve të tjera të Ballkanit, prejardhjen e të cilëve popull i e lidh me Egjiptin"13 Siç shihet, edhe në mendimin shkencor, edhe në ndërgjegjen e popullit, fjala evgjit lidhet me Egjiptin. A nuk është emërtimi evgjit dhe magjyp një "pasaportë" etnikë fillestarë që atd-

heu i tyre i parë ua dha njerëzve të tij kur i nisi në shtegtimet e hershme nëpër rrugët e Ballkanit?! Emërtimi “evgjiti” ka përdorim të gjërë në Shqipërinë jugore, kurse emërtimi “magjyp” në Shqipërinë veriore. Ka edhe një emërtim tjetër në jugë: firaun, të cilën Fjalori e sqaron me këtë përkufizim: njeri i keq, shpirtkasmë, i djallëzuar e i pabesë.<sup>14</sup> Por ky është një kuptim dytësor i fjalës, kuptim figurativ. Cili është kuptimi i parë i kësaj fjale? Si shpjegohet prejardhja e saj?

Në të vërtetë me këtë emërtim është treguar me një ndjenjë përbuzjeje pjesëtari i grupit të evgjitëve. Kjo fjalë është në vetvete emri Faraon, i cili në rrjedhe të shekujve ka pësuar ndryshime fonetike: nga Faraon në Firaun. Emërtimi Jevg e që gjen një shtrirje përdorimi në Shqipërinë e Mesme, është një pseudoformë, që rrjedh nga plurali evgjitë me theks në rrokjen e parë dhe me rënie të zanores fundore -e. Pluralit evgjiti iu shtua një j- dhe u përftua forma e “jevgjiti” (krahaso: i ati = i jati, e ëma = e jëma). Nga plurali u kalua në një singular sipas analogjisë jevgjiti: jevg (krahaso: murgjiti : murg, peshqiti : peshk, turqiti : turk). Cilat janë mendimet e studiuesve të tjerë, historianë e antropologë shqiptarë për këtë grup shoqëror?

1. Në veprën “Esnafet shqiptarë”, duke cituar studiuesin e mirënjohur Faik Konica, autori flet për formimin e qyteteve shqiptare në mesjetë dhe shkruan se “përveç komuniteteve jomuhamedane, ishin edhe grype e jevgjve(ciganët) të ndarë në dy kategori: arixinj endacake apo gabele me origjinë nga India (krahsa e Harixhase, shteti i Katjavarit), dhe jevgjiti joshetitës (magjypet) me origjinë nga Egjipti e Sudani, banues, zakonisht, të periferive të qyteteve.<sup>15</sup>”

2. Në veprën “Raca shqiptare -studim antropologjik e historik”, e gjejmë këtë shtjellim: “Evgjitët e gabelët janë pjesëtarë të racës indide. Të parët thirren edhe magjypë ose jevgj. Duket se si në të gjithë Ballkanin, ashtu në Shqipëri janë shpërndarë me anën e turqve. Nuk kalojnë jetë nomade, por janë vendosur nëpër qytete të ndryshme ku zakonisht banojnë në lagje të veçantë të ndarë nga popullsia arbëreshe.<sup>16</sup>”

3. Në revistën shkencore “Studime historike” autori Andrea Nathanailli citon Veprën e studiuesit grek Kosta E.Biri “Romët dhe evgjitët - Etnografia dhe historia e ciganëve” dhe në shënimin e tij me nr.25 shkruan: “egjiptas në origjinal, -shqip evgjitë janë ardhur nga Egjipti, kurse ciganët (arixinjtë) kanë origjinë indiane’.<sup>17</sup>”

4. Ne librin e tij “Vite të vegjëlisë” autori Enver Hoxha shkruan: “... Ata nuk janë me origjinë egjiptiane, por indiane. Me grupe të mëdha që në kohën e Xhengis Khanit, por edhe më parë, ata kanë emigruar drejt Perendimit.18) Me tej ai shkruan: “Sipas një historiani francez, fjala evgjit nuk vjen nga Egjipti, por nga greqishtja “Iftes” që si duket mund të jetë e lidhur me një lokalitet në Poloponez... Ne në Gjirokastrë i quajmë “QIFTO” .19) Dhe në një nga fjalimet e tij “Sa më pëlqen të shëtisë në këto rrugë” ai shprehet: “... Por kur themi që kanë ardhur nga India Veriperëndimore, të kuptohemi: është fjala për këtu e 1500 vjet apo 1600 vjet përpara, pra në kohë të lashta.”. Nga sa u parashtrua më lart, del se ka një farë pështjellimi në përdorimin e emërtimeve për grupin shoqëror të evgjitëve. Ndërsa tek Sami Frashëri, Jakov Milja, Andrea Nathanaili, Kosta E. Biri përdoren emërtimet evgjit, jevg, rmagjyp si sinonime midis tyre, tek vepra “Esnafët shqiptarë” emërtimi jevgj përdoret si sinonim i emërtimit cigan, dhe kjo fjalë është përdorur si sinonim i emërtirneve arixhi dhe gabel. KY ËSHTË NJË PERDORIM I GABUAR SEPSE NUK NJIHET KUPTIMI I SAJ! Siç u shpjegua më lart, kjo fjalë është sinonimi i fjalës evgjit. Përdorimi i gabuar i saj vërehet edhe sot në jetën e përditshme nga ana e popullsisë arbëreshe (shqiptare). Kurse për grupin shoqëror me origjinë indiane janë përdorur këto emërtime: cigan, arixhi, gabel, rom.

Për origjinën egjiptiane të evgjitëve shprehen autorët: Sami Frashëri, Faik Konica, Prof. Dr. Aleksander Xhuvani e Eqrem Qabej, Kosat E. Biri, si dhe Akademia e Shkencave në Fjalorin e vitit 1980 dhe 1984, duke u mbështetur në mendimin popullor. Për origjinën indiane shprehet Enver Hoxha.

Dy janë shtrembërimet shkencore që vërehen në thëniet e tij:  
a) Gjuhësore: sipas tij, fjala evgjit nuk ardhka nga Egjipti, por nga greqishtja “Iftos”;

b) Historike: sipas tij, evgjitët kanë origjinë indiane. Por a nuk u tha më lart se emërtimi magjyp ka ardhur nga emri Egjipt, i cili në gjuhën latine është Aegyptius dhe në gjuhën greke. A thua se Enver Hoxha korrigjon dijetarët e mëdhenj të gjuhës shqipe? Vetë fjala “Iftos”, ashtu si gjirokastriçja “qifto”, një shqiptim i së parës, reflektojnë pikërisht emrin Egjipt në shqiptimin e gjuhës greke, dhe jo një lokalitet në Peloponez. Ai është kontradiktor në thëniet e tij në përcaktimin e kohës së shpërnguljes së evgjitëve: herë pohon për kohën e Xhengis Khanit, herë për një kohë më

të lashtë, këtu e 1500 apo 1600 vjet përpara. Kujt duhet fi besojmë? Por një buzëqeshje këtyre thënieve amatoreske, politizuese dhe le të kalojmë më tej.

Të dhënat e studiuesve të lartpërmendur tregojnë se evgjitetë banojnë vetëm në vendet ballkanike prej shekujsh, dhe janë një popullsi qytetare, në lagje të veçanta. Burrat janë marrë me zanate të tilla si: teneqepunues, farkëtarë, muzikantë, si dhe kanë shërbyer si forcë e lirë pune: gratë dhe vajzat, të lëna pa shkollë, punonin shpesh në shtëpitë e qytetarëve duke bërë të gjitha punët e shtëpisë: lanin, fshinin, gatuanin, rritnin fëmijët dhe, për të gjitha këto, kishin fituar respekt të madh si gra të pastra, të urta, punëtore dhe te ndershme. Familjet më të pasura të qyteteve pajtonin në shtëpitë e tyre gra të tilla dhe ishin krijuar rnarrahënie të ngushta respekti midis familjeve.

Në rrjedhë të shekujve, evgjitetë ishin integruar në shoqërinë qytetare shqiptare.

Ndryshe ka qenë jeta e romëve, ose siç njihen më shumë me emrin arixhinj, të cilët kanë bërë jetë endacake, brenda taborit të tyre, banonin në çadra, dhe janë marrë me shitje kuajsh, shportash, sitash e shoshash. Ata dallohen si një grup i mëvetësishëm etnik, sepse përdorin edhe sot e kësaj dite gjuhën e tyre. Romët janë të shpërndarë në gjithë Europën në shekullin XIV, ndërsa koha e shpërnguljes së evgjitetëve i takon shekujve të parë të erës së re. Për këtë duhen studime dokumentesh dhe të vilet literatura përkatëse në vendet e ndryshme të Europës, si dhe të kërkohet e të sigurohet bashkëpunim i ngushtë me historianë të institucioneve shkencore të EGJIPIT!

### Literaturë e shfrytëzuar:

- 1) Çeboksarov N.N., Çeboksarova I.A. "Popujt, racat, kulturat" Moske, 1971, fq.19.
- 2) Çeboksarov N.N., Çeboksarova I.A. "Popujt, racat, kulturat" Moske, 1971, fq.20.
- 3) Për këtë çështje do të sjellim dokumente e shkrime të tjera.
- 4,5,6) Frashëri Sami, *Vepra 1*, fq.252, fq.241 , fq.243, Tiranë, 1988.
- 7,8,9,10) Frashëri, S. *Vepër e çituar* fq.407, 409, 411, 421.
- 11) Qabej Eqrem "Studime gjuhësore" III fq. 165, Prishtinë 1976
- 12,13,14) Akademia e Shkencave: FqJSSH, fq.439 dhe 474, Tiranë 1980.
- 15) Shkodra Zija: "Esnafet shqiptarë", Tiranë, 1973, fq.52
- 16) Milaj Jakov: "Raca shqiptare..." Tiranë, 1944, fq.127.
- 17) Nathanailli Andrea, "St. historike" Nr.2-1975, fq.
- 18, 19) Hoxha Enver "Vite të vegjëlis" Tiranë, 1983, fq.291.
- 20) Hoxha Enver "Vepra 64", fq.

## **Prof. Dr. Skënder Riza**

### **Me çfarë kuptimi përdoren emrat egjiptian, ashkalinj dhe rom?!**

Në tri vitet e fundit dolën në skenë politike, shoqërore dhe kulturore emrat: egjiptian, ashkalinj dhe rom. Këta emra po përdoren pa kuptim të përkufizuar kombëtar, etnik dhe bashkiak.

U formuan edhe partitë politike të këtyre pakicave etnike. Përveç kësaj, me këto tri emra në zgjedhjet e fundit parlamentare (2001) u zgjodhën deputetet të parlamentit të Kosovës edhe përfaqësuesit e tyre.

Megjithëkëtë, jo vetëm gjatë fushatës parazgjedhore dhe në emisionet speciale televizive, por edhe në Parlamentin e Kosovës, paraqitjet e udhëheqësve – deputeteve të këtyre kategorive pakicash etnike ishin konfuze, kontradiktore dhe ndonjëherë edhe absurde.

Më këtë rast mbase do të përjashtonim paraqitjen e zotëri Bislim Hoti, kryetar i partisë “Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (egjiptiane) dhe deputet në Parlamentin e Kosovës, i cili në një emision të RTK, kishte dalë me një qëndrim mjaft konstruktiv sa i përket kësaj çështjeje.

Sipas këtij personaliteti: *“Udhëheqësit e ashkalinjeve dhe të romëve numrin e pakicave të tyre e kanë fryrë aq shumë sa që , gjykuar sipas të tillëve,*

*po na del se kinse Kosova paska 4 milion banorë. Në këtë mënyrë shqiptaret po na dalin pakicë kombëtare."*

Sinonimi ashkali, për emrin egjiptian është emërtim lokal, i cili përdoret vetëm në rrafshin e Kosovës. Ndërkaq, në rrafshin e Dukagjinit përdoret sinonimi tjetër – magjup. Këto sinonime (shkali dhe magjup) nga shqiptarët përdoret me kuptim përbuzës.

Egjiptianët e Shqipërisë Etnike (Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia) janë me prejardhje nga Egjipti. Gjuha e këtyre është shqipja prandaj quhen egjiptian shqiptar. Më saktë, siç quhen në popull, magjup-shqiptar, apo ashkalinj-shqiptar. Nga ana tjetër, romet janë me prejardhje nga India dhe gjuha e tyre është rome.

Lidhur me historinë e magjupeve (egjiptianeve) dhe romëve deri me sot ka studime nga studiues të ndryshëm. Madje, edhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë e dëshmon prejardhjen e këtyre dy etniteteve: të magjupeve (egjiptianeve) nga Egjipti dhe të romeve nga India.

Sipas enciklopedive botërore, rom, arinj ose cigan janë sinonime. Cigan-i m.sh. -ë, -ët. Pjesëtar i një popullsie me prejardhje nga India dhe që jeton zakonisht në mënyrë endacake a gjysmendacake në Evropë, në disa vende të Azisë dhe të Afrikës. Gjuha cigane. Këngë (valle) cigane. Jeta cigane.

Nga ana tjetër, magjupet, evgjit, më saktë egjiptianet, sipas rezultateve nga hulumtimet e studiuesve perëndimor janë me prejardhje jo nga India, por nga Egjipti. Në të mirë të këtij konstatimi dëshmojnë këto të dhëna historike:

Pellazget, stërgjyshërit e shqiptareve, djepi i të cilëve ishte Gadishulli Ballkanik, gjatë mijëvjeçarëve IV-I p.e.s., për shkak të shtimit të madh të tyre u detyruan të përhapeshin në anë të ndryshme të botës – në drejtim të Evropës, të Azisë dhe të Afrikës, me ç'rast e krijojnë perandorinë e tyre shumë të madhe –Perandorinë Pellazgjike.

Kështu një grup i konsiderueshëm pellazgësh të vendit Palesta ( në Himarë – Shqipëri Jugore), para 3.200 vjetëve shpërngulen nga Palesta për në ishullin Kreta. Më pastaj, nga Kreta dynden për në Azi të Vigël ku e krijojnë shtetin e tyre me emrin Palestina: Palest-ina=Ana e palesheve ( në pellazgjishte - shqipe).

Këtu duhet të shtojmë faktin se pellazgjishtja – shqipja ishte gjuhë universale dhe popullore e komunikimit në këtë pjesë të botës. Këtë fakt dhe fenomen historik e dëshmojnë me argumente relevante një serë studiuesish – pellazgolog të huaj dhe shqiptarë. Kështu, sipas Robert d'Angely-t: "Nga koha e Jezu Krishtit, për shembull, e vetmja gjuhë mbi-

zotëruese që është folur në të gjitha perandoritë romake ( në Evropë, në Azi dhe në Afrikë), ka qenë shqipja, dhe fryma e saj nuk do ta kishte një fakt të tillë që ta luante atë rol të rëndësishëm, të cilin ka mundur ta luante. Latinishtja dhe greqishtja nuk kanë qenë, ashtu si sanskritishtja, veçse gjuhë letrare dhe ditore. Lidhur me këtë ja se çfarë ka shkruar A. S. Sayce (në “Principes de Philologie comparee”, parathënia e botimit të parë, Paris, 1884, f. XIII). ‘ sanskritishtja është qenësisht një gjuhë diturie, që kurrë nuk është folur, ashtu siç na e tregojnë dokumentet. Ajo u shërben sot priftërinjve dhe letrareve. Ajo është shfronësuar nga vendi i lartë që zinte si përfaqësuese e veçantë e gjuhës mëmë ariane ( pellazgjike – shqipe), dhe është pranuar se nga disa pikëpamje gjuhët evropiane kanë ruajtur me besnikëri tingujt e formës primitive, sesa i kanë gjuhët e Indisë. ‘ ne po e citojmë këtë pjesë vetëm sepse ajo konfirmon nga të gjitha anët mendimin tonë po për këtë çështje, domethënë se ka qenë gjuha pellazge ose shqipe ajo që duke u nisur nga 3.000 vjet para Krishtit ka sjellë lindjen e gjuhës primitive të Indisë dhe , vetëkuptohet, gjithashu të sanskritishtes...”.

Madje edhe Librat e Shenjta të zbritura profetëve, që nga profeti Adem e deri të profeti Muhamed, kanë qenë të shkruara në gjuhën që e dinte dhe kuptonte populli, pra në pellazgjishte hyjnore, më saktë në gjuhën shqipe.

Lidhur më këtë fenomen opsioni shqiptar ka pasur mundësi të njoftohet përmes veprave të dijetarit të shquar arbresh Giuseppe Catapano: “*Thot – Tat për laven albanese* “ dhe “*Antichita della Lingua albanese (... anche Cristo parlo questi idioma)*”.

Tani po kthehemi sërisht te problemi i egjiptianëve – shqiptar. Këtu, pra, një numër pellazgë të Egjiptit, të cilët për arsye deri më sot të panjohura, janë shtrënguar të dynden në Siujdhesën Ballkanike, kanë ardhur këtu me gjuhën e tyre amtare pellazgjike – shqipe – egjiptiane. Këta të shpërngulur, në të vertetë, kanë kaluar nga një trevë e Pellazgjisë në trevën tjetër të saj – në djepin e pellazgëve – në Gadishullin Ballkanik. Për këtë arsye, këta muhaxhirë janë quajtur, sipas atdheut të tyre të lashtë – magjupë ose gjupë, gjipë.

Fjala ma-gjup, ma-gjip ka dalë nga emri E-gjup, E-gjypt, E-gjipt. Mirëpo, emri magjup, me kohë, në mjedise tona ka marrë kuptim për-buzës, prandaj nuk do të ishte gabim nëse ky emër zëvendësohet me emrin egjiptian në pikëpamje etnike, kurse me emrin shqiptar në pikëpamje kombëtare.

Për më tepër, egjiptianët – shqiptarë, shqipen e kanë gjuhë amtare dhe kombëtare, ndërsa Shqipërinë Etnike (Kosovën, Maqedoninë,

Shqipërinë, ...) e kanë territor kombëtar dhe shtetëror.

Atëherë pra, egjiptianët në këtë mjedis na pikëpamje kombëtare duhet të jenë shqiptarë, sepse kombi egjiptian nuk ekziston askund në botë, pra as në Egjipt. Edhe egjiptianët në Egjipt në pikëpamje kombëtare janë arab e jo egjiptian sepse gjuha dhe kultura e tyre është arabishtja.

Emiri ashkali, duhet të hiqet krejtësisht nga përdorimi, sepse nuk e tregon as përkatësinë kombëtare as përkatësinë etnike, madje as përkatësinë territoriale. Më një fjalë, ky emër nuk ka kurrfarë kuptimi domethënës. Emri shkali ka dalë nga fjala shqipe: ashk/ël, - la, f.sh. -la, lat, copë e vogël dhe e hollë që shpëputet nga druri, kur e qajnë e presin me sëpatë. Pra shkali do të thotë: njeri që copëton dru me sëpatë; druvar.

Kumtesën time do ta përfundoj me dy ajete kur'anore dhe një hadith të profetit Muhamed.

“[O Profeti im, thotë Xhebraili:] Zoti (Rabbi) yt [All-llahu Krijues] u ka thënë engjëjve: ‘Unë gjithsesi do të mëshiroj – trupëzoj (tin) NJË NJERI [profetin Adem nga qenia ime]. Posa do të kompletoj këto [trupin e profetit Muhamed] do t’ia japë shpirtin [Ruh-i a’zam = shpirti absolut], shpirt ky i cili do të jëtë rreze e Shpirtit tim [Ruh-i ilaçi ose Ruh-i lika]. Prandaj, atij ju [engjëj] menjëherë përlunji ( bini në sexhde)” (Kur’an: 38/71, 72).

Këtë fenomen Profeti universal dhe unik, Muhamedi a.s., e shpjegon në këtë mënyrë: “Bëj be se të gjithë njerëzit janë vëllezër. As arapi, as axhemi (persiani) përka origjina, nuk kanë përparësi njeri ndaj tjetrit të gjithë janë pasardhës të Hz. Ademit. Të gjithë jeni prej Ademit, kurse ai është prej ‘tinit’ (qenies së Zotit). Për këtë arsye, mos u lavdëroni me arabizëm dhe axhemizëm. Kjo nuk është për lavdërim. Prandaj lartësoni veten te Zoti (Rabbi) me vepra të mira dhe evitoni veprat e këqija!”.

Me fjalë tjera All-llah xh.sh të gjitha krijesat tjera të kozmosit, pra edhe Tokën me krijesat e saj, i ka krijuar për hir të profetit dhe pasardhësve të tij – njëzve, me kusht që këto të mos i keqpërdorin njerëzit paskrupull, përkundrazi të tillët do të ndëshkohen rreptë nga Krijuesi i tyre.



## **Dr. Muhamet Pirraku**

### **Kush janë shqiptarët Egjiptianë Albanofonë?**

*“Madhështia e Perëndisë është të fshihen gjërat, kurse madhështia e mbretërisë është të ndriçohen ato!”*

**Solomani**

Ka kohë që në jetën tonë shoqërore, shtetërore e kombëtare shqiptare kanë dalur në shesh spicat dhe prapaskenat shekullore të okupatorëve, të cilët bartësve të faktorit ndërkombëtar të vendosjes së rendit të ri në Botë (me Kosovën dhe vendet shqiptare të tjera pikë eksperimentale), po I hynë në punë për të “dëshmuar” tipare anarkiste, jo shtet formuese të popullsisë etnike të Kosovës, e të cilat, shekuj me radhë, ishin në arsenalin ekspansionist të panortodoksizmit sllav e grek.

Këto insinuata antishqiptare sa vjen e po duken si argumente për faktin se shqiptarët etnik shumicë absolute, në mungesë të inteligjencies udhërrëfyese komb formuese dhe të pushtetit vendor ligjvënës e mbrojtës, nuk po tregojnë gjallëri integruese të fuqishme për krijimin e mirëqenies së grupacioneve etnokulturore të ndryshme.

Si njohës relativ i historisë së jetës dhe gjallërisë së shqiptarëve Egjiptianë albanofon, të vllëve, të torbeshëve e të boshnjakëve në Kosovë dhe gjetkë në trojet shqiptare, më irriton kur në shtyp, në radio dhe në televizion lexoj, dëgjoj e shoh lebetitjet e njerëzve të thjeshtë, punëtorë të ndershëm e liridashës, të cilët ankohen e kërkojnë mirëkuptim nga bashkë fqinjët, nga shumica etnike, se edhe ata janë qytetarë të Kosovës me të drejta e më përgjegjësi të njëjta, se ata nuk janë faktorë kolektiv për veprat kriminale ndaj popullsisë autoktone shqiptare për interesa të pushtetit serb të ndonjë plëngprishësi nga radhët e tyre.

Gjykimi drejtë i çështjes është në interes të humanizmit, të kombëtares, të shtetësisë dhe të pavarësisë së Kosovës dhe të ribashkimit të

Shqipërisë Etnike. Së këndejmi ne a kemi forcë mendore e gjykim të shëndosh politik ta njohim veten, ta njohim ardhmërinë tonë, ta njohim lirinë me mbretërinë e demokracisë?!

Shkurt dhe qartë: shqiptarët Egjiptianë, vllehtë, torbeshët, goranët dhe boshnjakët kanë pjesën e tyre në gjakun e shqiptarisë shekullore të Kosovës dhe të Shqipërisë Etnike, ndaj kanë përgjegjësinë edhe për ardhmërinë e Kosovës dhe të Shqipërisë Etnike, si grupe etnokulturore ose të riintegruara në shtetësinë dhe në kombësinë e Kosovës dhe të Shqipërisë së ribashkuar. Së fundi, pse shqiptarët të mos e bartin për flamur të ngritjes së shtetësisë së Kosovës dhe të Shqipërisë mendimin e Solomanit: *"Madhështia e Perëndisë është të fshihen gjërat, kurse madhështia e mbretërisë është të ndriçohen ato!"*

Këtu, para se të ndalem në problemin; shqiptarët Egjiptianë albanofonë, duhet të theksohet fakti se studiuesit shqiptarë më lehtë e kanë të ndriçojnë se kush janë e çka kanë bërë për shqiptarësinë e Kosovës Egjiptianët albanofon, vllehtë, torbeshët, goranët e boshnjakët se sa të ravizojnë të ardhmen e tyre si grupe etnike të veçanta apo të integruar në kombësinë historike shqiptare të Kosovës dhe Shqipërisë Etnike.

Vërtetë, është plotësisht e pa nevojshme të flitet për autoktoninë iliro-pellazgjike të shqiptareve të Kosovës dhe gjetkë në arealin shqiptar. Të etnisë iliro-pellazgjike janë edhe vllehtë, torbeshët, goranët dhe boshnjakët. Por, pa bredhur duhet të konstatohet fakti se nëse ka rendësi koha, përkatësisht vjetërsia e një etnie në këto vende, për pronësi në të sotmen dhe në të ardhmen e Kosovës dhe Shqipërisë Etnike, në ambientin iliro-albanofon, sipas shumë të dhënave, të parët janë vendosur shqiptarët Egjiptianë.

Në konceptin etnokulturor shqiptarët Egjiptianë, jo më një mbështetje të plotë, por vetëm si një përqsasje, aktualisht nënkuptojmë të gjithë elementin etnik me prejardhje të pakontestueshme nga Lindja e Largët, të cilët në ambientin shqiptar etnik njihen me disa etnonime që shënojnë dallime të prekshme etnike, civilizuere, psikike, fizionomike e të tjera të tyre. Këtu mund të përmendim konceptet për dy grupe me përkufizime të dukshme etnokulturore: Grupi etnik magjupët (gjysh, gjips, gjipçë, evgjitë, jevgjit, hashkali). Këta nuk flasin gjuhë tjetër përveç gjuhës shqipe. Grupi tjetër janë gabelët (cergarë, çergash, shkije magjupë). Gjuha e tyre gabele (gabelisht), dhe i takon gjuhës ariane, koine të ndryshme të gjuhëve që fliten në Indi. Vërtetë, Grupi i parë është i natyralizuar plotësisht në ambientin ku jeton, kurse i dyti është në rrugë për ambientim etnokulturor në mjedisin shqiptar.

Këtu, para se të shkonim më tutje, pa pasur për qëllim të ndalem

në detaje, duhet të konstatoj se në literaturën etnografike, gjuhësore, sociologjike dhe politike ka kohë që është futur koncepti rom, që shënon bashkësinë e të gjitha grupeve magjupe dhe gabele në Ballkan dhe në Evropë. Së fundit në Jugosllavinë avnojistë u fut edhe koncepti etno-kulturor kryekreje politik "Jugoslavenski egip?ani". Me këtë hap synohej ndërprerja e procesit të shqiptarizimit të gabelëve dhe shkëputja e Egjiptianeve albanofonë nga bashkësia etnokulturore e kombëtare shqiptare.

Sipas një gojëdhëne persiane, fillet e shpërnguljeve të bengaliotëve nga Bengali në Persi mund të kapen para penetrimeve të Lekës së Madh në Lindjen e largët, por në gjuhësi, sipas Dr. Skënder Gashit, ka supozime se dyndjet e romëve nga India në Persi janë midis shekullit VI-X, përkatësisht VIII-XII. Sipas literaturës leksikologjike jugosllave mendohet se ciganët nga India kaluan në Persi në shekullin X, e prej andej në Siri, në Azi të Vogël dhe në Egjipt, prej nga besohet se erdhën në Ballkan dhe në Podunavlje në shekullin XIV. Sipas Gashit në Evropë romët nuk përmenden para shekullit XV.

Këtu nuk është tepër të rikujtohen disa fakte: Pushtimet e Lekës së Madh dhe ato romake e bizantine që pasuan, hapen udhë për dyndjen e popujve dhe për gërshetimin e civilizimeve nga Lindja e largët, nëpër Lindjen e afërt në Egjipt dhe së këndejmi në Mesdhe dhe në Evropë. Ilirologët, si Stipcevic e të tjerë, kanë konstatuar se në mjediset e Ilirikut hasen gjurmët e një dyndje të hershme të popullsisë nga Lindja. Se a mund të flitet këtu për magjupët, është problem që duhet provuar. Një gjë mund të thuhet me mbështetje faktografike: Egjiptianët, pra magjupët albanofonë në mjedisin shqiptar janë vendosur para penetrimeve të pushtuesit hasian nemanjid serb në arealin e Shqipërisë Etnike. Për këtë ka dëshmi etnokulturore të pakontestueshme.

Së pari, siç thonë Çabej, Weigand etj. emri magjup, përkatësisht koinetë: gjysh, gjips, evgjit, jevgë në gjuhën shqipe erdhën nga greqishtja e vjetër përmes greqishtes së re.

Së dyti, koncepti etnik serb për romët është cigan, fjalë e ardhur nga zigeuner e gjermanishtes, kurse pejorativi mangup nga magup e greqishtes se mesme, bizanrinishtes.

Së treti, në arealin shqiptar nuk ka magjup albanofon të fesë katolike. Do të thotë, shqiptarët Egjiptianë u natyralizuan në shqiptari para ndarjes së kishës në ortodokse dhe katolike. Këta kaluan në islam së bashku me autoktonët albanofonë ortodoks të kishës samoiliane-klimentiane bullgare dhe nemanide shënsaviane serbe.

Së katërti, gabelët e ardhur në periudhën osmane ishin të fesë

islame dhe e ruajtën gjuhën gabilishte, koine të ndryshme. Për këtë janë dëshmi feja dhe gjuha e tyre në ambientet sllave ortodokse, por edhe shqiptare të krishtera.

Vërtet, në literaturën gjuhësore dhe historiografike evropiane thuhet se romët në Evropë depërtuan në shekullin X, por ardhja e tyre në Ballkan vazhdoi në periudhën nemanide dhe do të forcohet në dy shekujt e parë të pushtimeve osmane. Në Krisobulen e Banjskës, më 1318 përmendet koncepti magjup 'nici', kurse në Krisobulen e Deçanit përmendet trajta magjup 'ci. Ka mendime se koncepti i përmendur shënon etninë e bartësve, kurse sipas Mikloshiqit flitej për njerëzit " të cilët manastirit i jepnin bukë". Kjo tezë vije nga Max Vasmer etj.

Sipas hulumtimeve të mija, rreshtimet etnokulturore politike aktuale shqiptarët Egjiptianë dhe shqiptarët hashkali janë shumë të ngjashme ose plotësisht identike dhe u përkasin ardhjes më të hershme se ardhja e gabeleve. Ato fillimisht u vendosen si kolonë e krah pune zeztar në fshatra me popullsi anëse, por edhe në qytete. Në Rrafshin e dukagjinit qytetarët e Kosovës të cilët pretendojnë në emrin e ri etnokulturor shqiptarë Egjiptianë, vetën e njohin, dhe duan të njihen, vetëm shqiptarë, kurse nga shqiptarët dhe më tutje mbahen në distancë me konceptin etnik magjup, variant që e gjejmë në letërsinë popullore dhe në të ashtu quajturën letërsi e vjetër shqipe. Në Drenicë është i pranishëm koncepti magjup, por edhe pejorativi hashkali për ata që flasin vetëm shqip, ose për shqiptarët zeshkan. Në Rrafshin e Kosovës për këtë grupacion aktualisht dominon koncepti hashkali (varianti serbisht – shkali). Në gegërishten e Kurbinit përmendën me antonimin gjysh, në viset të Iliriadës – janë konceptet gjips, gjipçë, në Toskëri është koncepti evgjitë, dhe në vise të Tiranës, koncepti jevgjit.

Kjo popullsi albanofone me prejardhje persiano-Egjiptiane në mbarë arealin e Shqipërisë Etnike gjatë shekujve, është integruar plotësisht ose pjesërisht me popullsinë vendëse në aspektin civilizues-fetar ortodoks e islam dhe dialektor gjuhësor. Gjurmë të integritit të plotë gjejmë në kujtesën e prejardhjes magjupe-hashkalikiane të shumë vëllezërive shqiptare në mbarë arealin etnik dhe historik shqiptar. Këto vëllezëri kanë dhënë burra urtak, dijetar e muzikant, luftetarë e martir të shquar të shqiptarisë së Kosovës dhe të viseve të Shqipërisë Etnike. Dhe, pse të mos bëjmë një digresion: Kështu ndodhi me të gjitha kombet evropiane. Jevgjit i dhanë civilizimit anglez, madje, edhe një Shekspir të patejkalueshëm et.

Vërtet, rreshtimet aktuale etnokulturore politike: Shqiptarët Egjiptian dhe shqiptarët hashkali, nuk janë romë endacak – cergar as

romë gabel (koncept i gegërishtës, koine italiane). Madje, as mund të kapet ndonjë lidhje gjaku, etnie, krushkie e civilizimi me këta. Shqiptarët Egjiptianë dhe shqiptarët hashkali, siç thamë, me kohë kanë marrë gjuhën dhe fenë e mjedisit shqiptar, janë punëtor të virtytshëm, kanë shtëpi e plang dhe u përkasin fiseve shqiptare të vendit ku jetojnë. Këta për fatin e tyre lutën ose vajtojnë vetëm shqip. Këta, pandashëm, fëmijët i pagëzojnë me emra më të zgjedhur të personaliteteve shqiptare dhe veçanërisht pas Luftës së Dytë Botërore, fëmijët i pagëzojnë me emra shqip, njësoj si rrethina e tyre shqiptare: Shpëtim, Shpresë, Burbuqe, Burim, Kushtrim, Lulzim, Luljetë, Besim, Besnik etj., shumë më ndjeshëm se mjediset shqiptare të krishtera. Ka kohë që janë vë në këtë hulli edhe gabelët të cilët fëmijët i dërgojnë në shkollën shqipe, më me dëshirë se sa në gjuhën serbishte të imponuar, dhe këta, gabelët, janë duke përballuar pengesat e pushtuesve në rrugën e gjatë të integritimit civilizues shqiptar, për ta zgjedhur përjetësisht, e historikisht drejt, çështjen e përkatësisë kombëtare të pasardhësve të tyre.

Vërtetë, në fazën e civilizimit shqiptar që janë, shqiptarët Egjiptian dhe shqiptarët hashkali por edhe gabelet në ambientin shqiptar, çdo mjedis etnik e kombëtar tjetër në Ballkan e në Evropë, do t'i konsideronte pjesë përbërëse të pandashme të kombit të tyre. Ndaj, kam guximin të rikonstatoj se kërkesat aktuale, thënë shqiptarqë, të magjupëve dhe të hashkalive, por edhe të gabelëve të Kosovës dhe viseve tjera të Shqipërisë Etnike, për identitet etnik e civilizues të veçantë, për shoqata kulturore të veçanta, madje edhe për shkollë në gjuhën gabele, është pasojë e pa aftësisë kombformuese dhe shtetformuese të shqiptareve dhe në rend të parë të inteligjencies, e cila duhet t'ishte gjallëruese e kombit si bashkësi shoqërore, civilizuese e shtetërore politike unike.

Kujtimi e krenaria shqiptare për kombin me gjak ilir të pastër, si dikur te gjermanët për kombin me gjak arian, janë antihistorike, janë antikombëtare dhe janë johumane. Duke i mbajtur magjupët përkatësisht hashkalinjtë, por edhe gabelët, vlehët, torbeshët, goranët dhe boshnjakët në distancën shqiptare dhe aktualisht duke i "bojkotuar", për faktin se ndonjë plangprishës nga radhët e tyre e ka keqpërdorë okupatori me para, me nëpunësi apo me dhunë, finansojmë paudhësinë dhe telashet për shqiptarët dhe për ata, kundër të ardhmes së shtetësisë së Kosovës e të Shqipërisë Etnike. Mbi të gjitha finansojmë për dënimin e brezave të reja të këtyre grupimeve etnokulturore për të qenë përjetësisht ignorant, të huaj, në vatrën e tyre iliro-shqiptare ku u lindën gjyshër e stërgjyshër.

Për fat të keq të tyre dhe kombit shqiptar, në këto zhvillime retrograde po financon Bashkësia Ndërkombëtare, pikërisht në emër të

lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve etnike. Ndërkaq, qëllimi dihet: kurdisja e fitilit për të destabilizuar zhvillimet dhe mirëqenien në kombin shqiptar aktualisht të copëtuar me dhunë ndërkombëtare. Rreshtimet etnokulturore politike aktuale: shqiptarët Egjiptianë dhe shqiptarët haskali, por as gabelët, sikurse vllahët, torbeshët, goranët e boshnjakët në ambientin shqiptar etnik, duhet të udhëzohen e të ndihmohen në zhvillimet drejt ardhmerisë shqiptare dhe jo në getoizim të pa asnjë prespektivë. Së fundi e së paku, në rrethanat në të cilat gjendet Kosova dhe shqiptaria, rreshtimet etnokulturore shqiptarët Egjiptianë dhe shqiptarët haskali duhet të bashkohen me një emër të përbashkët, përreth shqipes dhe Flamurit të shtetësisë shqiptare. Kërkesat për thyerjen në gablishte e në romë, që nuk dihet se i kishin, është dhunë ndërkombëtare mbi këtë rreshtim etnokulturor historik.

## **Dr. Marcel Courthiade**

Gëzohem shumë që më në fund çështja e miqve tanë Egjiptian merret para sysh me dinjitetin që meriton çdo komb, kombësi apo minoritet, pavarësisht nga numri i tij apo nga historia, profili etno-kulturor, trashëgimia gjuhësore apo situata sociale. Po ju dërgoj disa materiale që kisha përgatitur kohën e fundit e që janë botuar në Paris.

Jam i bindur se duhet ndarë çështja e identitetit nga çështja e solidaritetit. Po, patjetër duhet të punojmë si me miqtë egjiptian, po ashtu me të gjitha kombet, kombësitë e minoritetet e botës, me një qëllim të përbashkët, i cili përbënë të vërtetën historike e shkencore, përkrahjen për ata që janë në një pozitë të shtypur apo të mohuar, përpjekje të përbashkët për të ngritur një botë më njerëzore e me vëllazërore, me drejtësi e respekt mutual midis njerëzve e midis identiteteve. Nuk duhet të kemi ndasi në këtë drejtim, por nga ana tjetër duhet të pranojmë atë që na sjellë studimi historisë, i gjuhës, i traditave, i gojëdhënave etj.

Nuk duhet ngatërruar gjithashtu plani kolektiv e plani individual: në planin kolektiv janë disa të dhëna shkencore, historike, kulturore etj... që nuk mund të mohohen, por nga ana individuale është e qartë se identiteti nuk mund të prehet dot me thikë: të gjithë jemi produkti jo vetëm i një kombi apo kombësie nga kemi dalë, por edhe nga inercionet, shkëmbimet e pasurimit mutual midis identiteteve në shoqëri. Kur them identitet, nuk mendoj vetëm për identitetin etnik, por më gjerë: profesionale, politike, gjinore, regjionale etj. Prandaj njeriu ka identitet të shumëanëshëm, që nuk mund të reduktohet në një karikaturë ose eksponat muzeal.

Do të ishte gabim të besojmë se “ në qoftë se jemi më shumë, jemi më të fortë”. Kjo është ligji i xhunglës. Më i miri është propozimi: “në qoftë se jemi më me vetëdije, më me dije, më me qartësi intelektuale si dhe më të lidhur në shpirtin e solidaritetit, atëherë më të vërtetë do të

jemi më të fortë”.

Shpesh herë janë ngatërruar këto të dyja: nga një anë uniteti i identitetit (prejardhja, kultura etj...), dhe uniteti i veprimit nga ana tjetër (politika, angazhimi, lobby etj...). në vend që të qojë në një kohezion më të fortë të identiteteve, ka qarë në mohimin e shumicës prej tyre. Këtë politikë e kanë ndjekur shumë shtete në dëm të minoriteteve, për të ndërtuar një “komb –shtet” më të fortë, duke mohuar minoritetet, e si pasojë, duke emituar vetë “shtet-kombin” që po e ndërtonin. Fatkeqësisht këtë politikë e kanë ndjekur edhe mjaft lider Rom, duke mohuar identitetin Egjiptian, ose duke e kthyer në një rimorkio të identitetit rom për hir të numrit. Në këtë aspekt, kanë ndjekur e imituar politikën mohuese të “gaxhive”.

Në Evropë tani ngritët nocioni i minoriteteve pa territor kompakt. Jemi afro dhjetë minoritete të tilla në kontinentin tonë dhe Romët, Egjiptianët, Vllenjët, Laponët, Euro-amazigët e Beashët, për të përmendur vetëm disa prej tyre, bëjnë pjesë në këtë numër. A duhet të themi se të gjithë janë romë? Në asnjë mënyrë. Atëherë pse të thuhet se vetëm Romët, Egjiptianët e dy tre grupe tjera janë Romë? Vetëm për të ndjekur etiketimin që kanë bërë para disa shekujsh disa katunar analfabet në Perandorinë Bizantine. Duket qartë se kjo nuk është një burim shkencor prandaj është më e drejtë nga ana shkencore, si dhe nga ana njerëzore, që ta konsiderojmë Evropën me këtë koncept të minoriteteve pa territor kompakt ku ne jemi një pjesë e saj. Disa që janë më guximtar thonë edhe “kombe e kombësi pa territor kompakt (ose me vendbanim të shpërndarë)” përbri kombeve e kombësive me territor kompakt, por kjo akoma nuk ka hyrë në fjalorin evropian.

Lidhur me këtë po përgatisim një ekspozitë për Bashkinë e Parisit. Do të mbahet në maj 2004, në kuadër të festivalit “Montmartre en Europe” e shpresojmë që do të mbahet paralelisht një kuvend shkencor me paraqitjen e këtyre minoriteteve pa territor kompakt, të cilat shpesh herë janë harruar nga Evropa. Ne që jemi të njohur me planin evropian kemi për detyrë të ndihmojmë miqtë tanë të harruar në afirmimin e identitetit të tyre, jo ti mohojmë edhe ne apo t’i asimilojmë kundër të dhënave shkencore e kundër dëshirës së tyre.

Jam shumë i kënaqur për mbajtjen e kësaj konference në Institutin e juaj. Po ju dëshiroj shumë sukses e të jepni një ndihmesë me rendësi për të vërtetën shkencore, e si pasojë, për paqen e stabilitetin në Ballkan e më gjerë, sepse paqja e stabiliteti ndërtohen më fortë në bazë të analizave të qarta sesa në bazë të spekulimeve me interes pamje shkurtër.

### **Dr Marcel Courthiade**

Profesor në Universitetin e Parisit (INALCO)

Komisar i Bashkimit Ndërkombëtar të Romëve për gjuhën e të drejtat gjuhësore



## **Dr. Maliq Osi**

### **Identiteti kombëtar të shqiptarëve egjiptas kosovar**

Temë tejet interesante, sa është interesante, aq është e ndjeshme. Për të qartësuar këtë çështje lypset koha, duhet bërë hulumtime shkencore, paralel me të edhe konsultim të gjerë të literaturës, sepse vetë natyra e temës është llojit të tillë që kërkon trajtim jo vetëm nga aspekti historik por edhe atë të shkencës më të re sociologjinë dhe shkencat tjera shoqërore.

Sidoqoftë, ajo që më shtyri më se shumti të marrë pjesë në këtë tryezë ishte Korniza Ligjore e Bashkësisë Ndërkombëtare për qytetarët e Kosovës. Rastësisht më ra në dorë, lexova dhe ajo që më ra në sy ishte klasifikimi i minoriteteve që jetonin në Kosovë dhe radhitja e tyre në grupe. Në kornizë shkruan si vijon:

në grupin e parë kishin caktuar mazhurancën shqiptaro-arianite;  
në grupin e dytë minoritetet: Serbët, Turqit dhe Boshnjakët dhe  
në grupin e tretë minoritetet: Romët, Shqiptarët egjiptas dhe Ashkalinjtë

Kjo ndarje për mua ishte e pa kuptimtë! Së pari nuk kuptoja ç'është ajo mazhurancë, ndoshta term i ri për shqiptarët, të thuhej në Kornizë ligjore se janë mazhurancë e të theksohej me emërtim "shqiptaro-arianite", në çka aludohej atë nuk e di..?! Nëse mendohet për popullin shqiptarë që banon në Kosovë si shumicë, atëherë në dakord. Vërtetë ata mund të radhiten në grupin e parë edhe si popull por edhe si komb.

Por nëse Korniza ligjore e ndërkombëtareve e nënkupton që edhe shqiptarët janë minoritet, atëherë ai dokument do të konsiderohej me një të metë, nga dija ose mosnjohja, që ende shqiptarët të trajtohen si pakicë, minoritet apo kombësi, ndoshta në ndërdije të ndërkombëtareve mbi-zotëron ai mendimi që të vazhdonim ashtu siç ishim në të kaluarën nën federatën e asaj Jugosllavie më të shpërberë. Mirëpo kjo ndërdije nuk mund të jetë e qëndrueshme nga se pas shpërbërjes së ish Jugosllavisë, në truallin e saj linden shtete të reja si: Sllovenia, Kroacia, Maqedonia dhe Bosnja Hercegovina. Ndërkaq, Serbia ende e kësaj dite këmbëngul që me marifetlleqet e saja shqiptarët e Kosovës t'i mbajë të varur nga ata, Kosovën t'a llogarisë si pjesë e tyre e popullin kosovar të trajton si minoritet, duke harruar se Kosova ka qenë element konstituiv i asaj Jugosllavie federative edhe përkundër kësaj, se janë të vetëdijshëm se shqiptarët përbënin Kosovën mbi 90% të popullsisë së trevës së vet.

Andaj drojë se vallë mos është ndonjë kurdisje, që kaq po na mundonin edhe në ditët e sodit përmes protektoratit të Misionit të Përhershëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara siç na preferonin përmbushjen e standardeve e në atë mënyrë të ecnim përpara drejtë Unionit Evropian, respektivisht të hyjmë në familjen e një Evrope demokratike e qytetëruese. Mirëpo, nëse emërtimin "Mazhurancë shqiptaro-ariani?te" e kanë bazuar në diçka e të na tregonin se populli shqiptarë është i lashtë, i vjetër si dhe autoktoninë i cili ka banuar në Gadishullin Ballkanik, atëherë pajtohemi. Në të kundërtën, nëse jo atëherë t'i udhëzojmë në veprën burimore "Kamus-ul-a lam " të Sami Frasherit e të mësojnë se kush janë Arianitët? Ja se çka thotë Samiu: "Sa i përket kuptimit etimologjik të kësaj fjale, të themi se është fjalë e krijuar prej pjesës <<Ar>>=arë (tokë e punuar) dhe pjesës <<Ban>> po si në persishten ai i cilibenë=punon. Andaj, me një përkthim të lirë mund të themi se fjala <<Arban>> na jep kuptimin e "bujkut". Është një e vërtetë e pamposhtur se këta janë të parët të cilët në Eoropë e prunë zejtarinë, profesionin e bujqësisë. Këta janë popujt arianë të ardhur nga Azia e Mesme, ndërsa populli shqiptarë ndër ta është populli më i vjetër. Meqë edhe në gjuhë tjera të vjetra ariane fjala <<arë>>, apo <<Arg>> jep kuptimin e tokës së punuar, kështu edhe fjala <<Arja>>, me të cilën quhen shumica e popujve në fjalë <<Arija>>. Këtë fakt na vërteton edhe gjuhëtari Maks Myler pohimi i të cilit është argument i fortë, i cili përforcon hipotezën time". Ndërlidhur me këtë, në një vend tjetër Samiu vijon:

*"Më vonë, kur disa hulumtues evropian u njoftuan me gjuhën shqipe dhe panë se kjo gjuhë sa është në lidhmëri me gjuhën e greqishtes së vjetër, latinishten, sllavishten, gotishten, persishten dhe sankrishtën. Duke marrë për bazë gjuhën si dhe duke krahasuar historitë, kanë kuptuar prejardhjen (origjinën) nga*

kanë ardhur dhe se kush janë shqiptarët. Kjo çështje e cila ishte nyje e pa ç'thurur shekuj me radhë, tani më është zbuluar definitivisht. Kështu, tani është vërtetuar dhe dihet se shqiptarët janë kombësi më i vjetër prej kombësive Azio-Evropiane të cilët njihen me emrin e përbashkët <<Arijan>>.

Sa i përket grupit të dytë, nuk kam vërejtje sepse vërtetë u takonin minoriteteve nga se ato i kanë shtetet e tyre amë: Serbët shtetin Serb, Turqit Republikën Turke dhe Boshnjakët shtetin të posa formuar Bosnjën dhe Hercegovinën.

Mirëpo t'a fusësh në një thes: Romët, Shqiptarët Egjiptas Kosovar dhe Ashkalinjtë e t'i trajtosh si minoritete, këtë unë nuk e shoh të arsyeshme. Si është e mundur që Bashkësia Ndërkombëtare këtë grup të tretë që e ka përbërjen nga më të ndryshmit e t'i trajtojë si një kur dihet se Romët dukshëm dallohen nga Shqiptarët Egjiptas kosovar e Ashkalinjtë? Para se të flasë për këto dallime e për të kuptuar më mirë, më duket se kemi nevojë këtu t'a sqaronim ç'është kombi e më pastaj edhe t'a kuptonim edhe domethënien, jo vetëm të minoritetit por edhe të një grupi më të vogël etnik që eventualisht mund të banonin në Kosovë, e që mund të vërehen aty këtu sipas gjurmëve të lëna, si bie fjala ndonjë apo më shumë familje e të kenë qenë Çerkezë apo Tatar.?!

Pra, ç'është kombi? Asgjë pos të themi dukuri shoqëroro-historike e cila përfaqëson tërësinë organike të ekonomisë së përbashkët, të territorit, të gjuhës, dhe të kulturës.

Pjekurinë më të lartë shqiptarët e treguan gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX, periudhë kjo më të cilën filloi procesi i fazës së fundit të konsolidimit të kombit shqiptar. Duke iu falënderuar vetëdijes së lartë kombëtare është zhvilluar luftë e pa kompromis kundër epsheve gllabëruese të shteteve ballkanike që e kishin mbështetjen e fuqive të mëdha, veçanërisht të Rusisë pansllaviste dhe luftë kundër absolutizmit Hamidian. Fjala është për Lidhjen e Prizrenit (1878) e cila bëri një kthesë të madhe në historinë e popullit shqiptarë edhe përkundër asaj që e shujtën këtë lëvizje. Ata zhvilluan luftë edhe tri decenie pas saj për të fituar e pavarësuar një Shqipëri, por të cinguar, të shpallur në Vlorë më 1912, pa e përfshirë, pos vilajetit të Shkodrës edhe ato vilajetet të tjera siç ishin: Janina, Manastiri dhe Kosova, që atëherë me një emër quhej Arnavutllëk.

Por çka të themi për ata shqiptarë që mbeten jashtë trungut të vet. Shqiptarët e Kosovë, Maqedonisë, Çamërisë, Malit të Zi dhe Serbisë Lindore (Presheva, Bujanovci e Medvegja). Në të kaluarën, plot një shekull e një çerek, gjithnjë na kanë trajtuar si pakicë, se gjoja na mungon territori, me pretekstin se shtetin amë e kemi Shqipërinë.

Harrojnë se gjatë tërë periudhës osmane Arnavutlluku, por edhe

më parë Shqipëria ka patur një sipërfaqe tokësore prej 90.170 km<sup>2</sup> e që përbëhet nga katër vilajete siç ishin:

Vilajeti i Shkodrës ka 294.100 banorë dhe sipërfaqe 10.870 km<sup>2</sup>

Vilajeti i Janinës ka 572.100 banorë dhe sipërfaqe 17.900 km<sup>2</sup>

Vilajeti i Manastirit ka 848.100 banorë dhe sipërfaqe 28.500 km<sup>2</sup>

Vilajeti i Kosovës ka 1.037.100 banorë dhe sipërfaqe 32.900 km<sup>2</sup>

**Gjithësej: 2.707.300 banorë dhe sipërfaqe 90.170 km<sup>2</sup>**

Nga kjo pasqyrë e sipërpërmendur, nëse do t'a veçoja vilajetin e Kosovës të asaj periudhe e të tregoj se me çfarë përbërje të popullsisë ka qenë dhe se me çfarë përkatësie kombëtare kanë qenë, më së miri do të na ilustrojnë këto shënime:

Shqiptarët e fesë islame .....	751.565
Bullgar .....	140.000
Serbë .....	69.000
Shqiptarë të fesë katolike .....	55.500
Grekë .....	7.000
Vllehë .....	5.000
Çifutë .....	595
Gjithësej:	1.028.660

Jo vetë këto por edhe shënime tjera interesante, si: "Të ardhurat vjetore të Kosovës në kohën e Perandorisë Osmane kanë qenë 531.316 lira. Xehet që në shumicë gjendën në Kosovë janë: kromi, plumbi, anti-moni, ari, magnezi. Prej Manastiri ka një numër të madh punëtorësh dhe katundarësh bullgarë, grek e çifut ka shumë pak. Kurse vilajeti i Shkodrës është krejt shqiptarë. Në vilajetin e Janinës ka shqiptarë, pastaj ka vlleh besnik dhe shqiptarë të greqizuar si dhe një numër helenësh të pastër.. banorë shqiptarë janë 2.300.000.

Nga kjo pasqyrë e sipërpërmendur e kemi të çartë përbërën e popujve në Arnavutllëk respektivisht Shqipëri gjatë periudhës Osmane. U përmenden bullgarët, serbët, çifutët, interesant nuk u përmenden romët. Duke konsultuar "Kamus-ül-a'lamin" e Sami Frasherit e pamë se ai përmend romët. Duke venë në raporte dallohen se dallohen nga të gjithë që i përmendëm ngase flasin një gjuhë që të tjerët nuk e kuptojnë do të thotë gjuhën e tyre rome, bëjnë një jetë nomade dhe janë me një numër të vogël, pos gjuhës së tyre në meset ku jetojnë kanë mësuar edhe gjuhën shqipe, flasin aq sa të kuptohen me fqinjët e tyre. Pra, krejt kjo bënë që romët deri diku ta ruajnë identitetin e tyre.

Kjo është ajo Kosovë që gjatë periudhës Osmane, më pastaj edhe gjatë periudhës ndërmjet dy luftërave botërore, që rënkonte nën dinastinë e Karagjorgjeviqëve deri më 1941, edhe gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore për më tepër edhe një gjysmë shekulli tjetër, rënkim pas rënkimi kur populli i Kosovës me një lëvizje gjithë popullore, në decaenien e fundit të shekullit XX t'a ndërkombëtarizoi çështjen e Kosovës.

Te populli shqiptar si duket më se miri është ruajtur emërtimi i këtij populli, gjatë periudhave të ndryshme historike të kenë lëvizur e të prirë nga ndonjë luftarak që përmes ekspeditave ushtarake të ecnin prej Ballkanit drejt viseve të largëta duke depërtuar në brendinë e Azisë apo Afrikës, të arrinin edhe deri në Egjipt. Sot e kësaj dite në Shqipëri e në Maqedoninë perëndimore ky popull shkurdhacak e ardhacak quhen gjipt - ër. Edhe në pjesën perëndimore të Maqedonisë tek banorët shqiptar vendas është ruajtur emërtimi gjiptë - tët, kështu emri Egjipt përbehet prej e - gjipt do të thotë Egjipt - egjiptian - gjipt - egjiptianët - gjiptët. Pra, duke u nisur nga kjo, këta shqiptarë egjiptas Kosovar, në këtë punimin tim do t'i trajtoj si shkurdhacak edhe si ardhacak. Më binin të dhënat historike të një historiani Ermenas, në veprën e vet, me titull: "Balkan Harbi Tarihi", ku në mes tjerash, në një kaptinë veçmas bënë fjalë mbi shqiptarët dhe Lekën e Madh, andaj e pash të arsyeshme që këtu ca pjesë t'i vë në pah:

"Shqiptarët ndoshta janë popull i vetëm në Evropë i cili gjatë periudhave të ndryshme historike nuk ka përjetuar kurrfarë ndryshimesh. Në kohën parahistorike, shqiptarët kanë jetuar në malet e thepisura. Aleksandri i Madh - Leka, është rritur në kulturën helene, ka folur greqisht, por kur idhënoheshte shante në gjuhën shqipe". (Aram Andonyan, faqe 179)

Shënimi se Leka i Madh është shprehur kështu, për herë të parë hasa te ky historian. Ndoshta kjo e dhënë ekziston edhe te ndonjë literaturë tjetër historike apo letrare. Sidoqoftë, kam përshtypjen se autori në fjalë është njohës i shkëlqyer i historisë së kësaj periudhe të Lekës së Madh dhe të vet personalitetit të tij, ngase kjo e dhënë është recidive e cila na thotë shumë. Së pari na bënë me dije identitetin e Lekës se është me origjinë shqiptar, më pastaj, si strateg i madh ushtarak, gjatë luftrave të ndryshme të lavdishme, herë herë edhe ndonjë dështim t'a ketë në fronte të ndryshme luftarake, ka qenë ndoshta në ndonjë situatë të pavolitsëm, ta qortoj ushtarët e vet, dhe ashtu i hidhëruar me plotë vnerë, ndoshta nga ata ushtarë që i takonin kombësive tjera, që ata të mos kuptonin, shante në gjuhën shqipe.

Në vijim autori thotë:

“Shqiptarët që shkolin pas Lekës dhe pasardhësve të tij, i shkelnin perandoritë aziatike, luftuan kundër perandorisë romake, që më vonë t’i nënshtrohen atyre. Në periudhën e hershme të shekullit të mesëm, depërtimi i Sllaveve u pykos deri te rrafshlartat e shqiptareve, por nuk mundi ato t’i gëlltis. Populli shqiptar i dashuruar në pavarësi, për ‘tu hakmarrë elementit sllav, në Kosovë ndihmuan pushtetarët kundër depërtimit të tyre, mirëpo kur Turqit deshën t’i nënshtrojnë, ata nën udhëheqjen e Skënder-begut të lavdishëm, filluan luftën kundër turqve dhe Skënder-beu deri në vdekje ishte ngadhënjyes – fitimtarë. Pas vdekjes së tij, së fundit turqit i nënshtroan shqiptarët, por nuk arritën t’a thyejnë kurrizin e tyre. Një pjesë e popullit shqiptarë u largua në Itali dhe u vendos në Sicili, ku ende sot jetojnë pasardhësit e tyre. Pushtetari i njohur italian Krispi është një nga ata. Pjesa dërmuese e shqiptarëve duke mos dashur t’i nënshtrohen presionit dhe për t’a ruajtur pronësinë tokësore dhe të drejtat feudale, kali në fenë islame. Ndërrimi i fesë për ta është një fitore politike. Ata nuk deshën t’i bashkëngjitën rajës, ndërkaq islamizimi në përgjithësi nuk i ndërroi doket, shprehjet dhe traditën; për ti ruajtur të gjitha këto qenë të detyruar që diçka të sakrifikojnë. Me kalimin në islam kanë mundur ti ruajnë armët e veta, si një domosdoshmëri për ruajtjen e nderit të vet, lirinë e në veçanti doket e shenjta të hakmarrjes së gjakut” (Aram Andonyan, *Balkan Harbi Tarihi*, 7, Sander Yayinlari, Istanbul 1975, faqe 179).

Lidhur më këtë edhe Sami Frashëri në “Kamus-ul-a’lam” shkruan: “se edhe Maqedonasit si ilirët, pasardhësit e të cilëve janë shqiptarët, i radhiti në grupin e dytë, si të tillë jetonin në Maqedoni. Ndërkaq, Thrakasit dhe Firigjiasit i radhiti në grupin e tretë dhe të katërtë të cilët për stërgjyshër të përbashkët e kishin popullin më të lashtë të ashtuquajtur Pelazgë, nga edhe e kanë origjinën.”

Andaj Aleksandri – Leka, si e cekëm më lartë nuk na qenka egjiptas ose t’a ketë origjinën nga Egjipti, por bashkë me ushtarët e vet me origjinë shqiptare e pushtoi Egjiptin.

Këto dhe të dhënat tjera, tek unë krijojnë një bindje se “Shqiptarët Egjiptas Kosovar” u emërtuan kështu, jo pse janë me origjinë egjiptas, por si shqiptarë të cilët kërkonin identitetin e tyre, ta lidhin me të parët e tyre në shembullin e personalitetit historik të Aleksandrit të Madh, respektivisht se i takonin popullit të lashtë dhe autokton që jetonin në Gadishullin Ballkanik. Identiteti i tyre është më se i qartë. Vetë gjuha e tyre amtare se flasin shqipen tregojnë përkatësinë e tyre se i takonin shtresave qytetare shqiptare, për më tepër atë përkatësinë e tyre e manifestojnë edhe me simbolet kombëtare siç janë: plisi i bardhë, flamuri kom-

bëtar shqiptar dhe himni kombëtarë shqiptarë. Prandaj pse quhen “Shqiptarë egjiptas kosovar”, këtë askush s’mund t’i mohoj, është e drejta e tyre ngase e ndiejnë veten ashtu, këtë secili prej nesh duhet respektuar. Kështu edhe për “Ashkalinjtë”, në esencë janë shqiptarë. Është e drejta e tyre të emërtohen ngase e ndiejnë veten ashtu. Të sqaronim edhe këtë! Tani të shtrojmë pyetjen, ç’do të thotë Ashkalinjë, çfarë domethënie ka ky termë? Kur e konsultuam fjalorin shqip-shqip, kuptuam se ASHIK, -U - Ë - ËT, 1. Dashnor, këngë ashikësh, zuri një ashik, 2. Njeri i dhënë pas qejfeve, ASHIKËRI. Dhe jo vetëm këtë fjalor, por edhe atë “Turkçe-Sirpça Sozluk”, mund të bindemi se: “A?k= dashuri”. Nëse i shtoni termin bazë a?k - fjalës ate?i= i epur pas dashurisë; ose a?k- gelmek=tepër i dashuruar; ose a?k yapmak=të duash; ose a?k serbest=dashuria e lirë; ose a?k vatan=dashuria ndaj atdheut etj.

Edhe në fjalorët tjerë hasim në të njëjtin kuptim por për ne domethënia më adekuate është kjo e fundit në turqishte ASHK VATAN-I=dashuria ndaj atdheut. Termi ashk në esencë është një shprehje që përdoret në gjirin e së cilit ka të bëjë me një popull me domethënie që e shpjegojmë më lartë. Sa për ilustrim të marrim shembullin e prizrenasit Suzi Çelebi. Ky u rrit dhe u edukua në Prizren. Në atë kohë qyteti posa ishte pushtuar nga turqit Osmanli. Suziu në këtë kohë filloi shkollimin e tij fillestar ndërkaq ato më të larta i vazhdoi në Konstatinopol (Stamboll). Ishte një talent i dalluar thekson Olesnicki. Gjatë shkollimit të tij, ai tregoi rezultate të shkëlqyera. Nuk ishte i shkëlqyer vetëm në lëmin fetar por edhe në lami të tjera nuk mund t’ja kalonte askush në Prizren dhe më gjërë. Syziu gjithnjë sillej në gjirin e dijetarëve dhe të krijuesve. Ai, përpos turqishtes dhe arabishtes që i zotëronte mirë, zotëronte edhe persishten. Persianët e quanin me një pseudonim “Suzi Çelebi” ku edhe në ditët tona njihet me këtë pseudonim. Ç’do të thotë “Suzi”? “Suzi” do të thotë: me afsh, i lartë, i flaktë, që digjet nga ashku, dashuria tek Zoti dhe si i tillë ishte. Ndërsa “Çelebi” do të thotë titull, në rend të parë i quanin princat. Në shekullin X-XVI i quanin Çelebi ata që merreshin me letërsi, poezi, shkrime. Përndryshe, emri i tij i vertetë ishte Mevlana Muhamed efendi in Muhamed Abdullah. (Dr. Maliq Osi, Prizreni qytet i lashtë, muze me thesar të pasur kulturor, Prizren, 2001, faqe 67-68).

Më duket se kjo e fundit është shprehje më adekuate që e bënë thelbin brenda vet shqiptarëve tani edhe shqiptarëve egjiptas dhe të ashkalinjeve, të cilët madhëngojnë të kaluarën e baballarëve, gjyshërve dhe stërgjyshërve të vet, jo pse janë egjiptas, por se gjatë periudhave të ndryshme historike, në veçanti të periudhës osmane, bashkërisht me turqit, arabët, sirianët, persianët, kurdët, lazët, tatarët, çerkezët, grekët,

boshnjakët, kroatët etj., duke i shërbyer ushtrisë osmane e zgjerojnë territorin e tij duke formuar një perandori të madhe e cila shtrihej në pjesët e tri kontinenteve dhe atë në : Azi, Afrikë dhe Evropë.

Po për romët çka të themi. Vërtetë janë minoritet, të vetmit janë në botë që nuk e kanë shtetin amë andaj nuk e shoh të arsyeshme të figuronin e të radhiteshin në grupin e tretë bashkë me shqiptarët egjiptas kosovar dhe me ashkalinjtë ngase dukshëm dallohen në mes veti që siç dihet ata e quajnë veten "Rom", term ky i përvetësuar ose i adaptuar i cili tani u zyrtarizua në literaturë sepse i largohen emërtimit përbuzës që ka mbizotëruar një kohë të gjatë duke u quajtur me termin Ciganë. Në esencë edhe janë CIGAN, -I, -Ë, -ËT, pjesëtar i një popullsie me prejardhje nga India veriperëndimore dhe jetojnë zakonisht në mënyrë endacake e gjysmendacake në Evropë dhe në disa vende të Azisë dhe të Afrikës. Gjuha cigane, kënga cigane, jeta cigane dhe sinonimi për ciganët GABEL, -I, -Ë, -ËT=cigan endacak, ovrixhi. Kur e konsultuam fjalorin Serbokroatisht-Shqip, hasëm edhe në termin ROMANI=m pl. Romane-et; m.pl., popuj latinë (ose) neolatinë; Romani -a f, vendet romane, që në tersi po na përputhet me atë të dhënë nga periudha e sundimit osman të asaj pjese të Turqisë Evropiane e që quhej RUMELIA. Pra, Rumeli turqisht - Rum lat+sufiksi turk ili=Tokë, vendi, shteti, krahina Rumeli - Urum - ili, Rum lat. Roma + ili = Rumeli=vendi - krahina e Romës, p[or Rum e ka kuptimin dhe grek, bizantines, pra si krahina e Bizantit. Kjo do të ishte më adekuate, emërtim që mbizotëroi gjatë tërë periudhës osmane për popuj tjerë, ndërkaq turqit ata i quajnë edhe me një emër tjetër "Çingene".

Kjo e dhënë për romët që sot veten e quajnë rom e arsyeton si duket në mënyrë të drejtë emërtimin në fjalë dhe padyshim këtë emërtim ata duhet ta ruajnë, kultivojnë edhe më tej ngase ashtu diktojnë marrëdhëniet shoqëro-ekonomike dhe politike-kulturore të zhvillimit dhe demokratizimit të shoqërisë sonë.

Shoqatat joqeveritare "Shqiptaro-egjiptase" në Prizren, Pejë, Gjakovë, Ferizaj, Istog etj sikur kanë plotë të drejtë, pavarësisht a kanë patur dijeni lidhur me këto të dhëna historike, i ipet e drejtë me plotë arsye që ata nuk mund të trajtohen si minoritet e të radhitur në grupin e tretë të minoriteteve aty ku janë edhe romët. Janë dy shtresa shoqërore brenda për brenda popullit shqiptarë, si popull shumicë në Kosovë, qytetarë të Kosovës si kurse edhe qytetarët e tjerë: serbë, turq, boshnjakë e romë që jetojnë në Kosovë t'a gëzojnë lirinë dhe të drejtat e tyre të plota.



## **Dr. Hakif Bajrami**

Përgjigjes në këtë pyetje që është shkruar këtu para jush është e vështirë t'i përgjigjesh aq më parë kur për dhjetë minuta duhet të themi diçka, moti nuk jam frikuar kështu që nuk mund të them asgjë. Megjithatë mendimi shkencor dhe etika shkencore nuk guxojnë të ndalen dhe këtë temë duhet ta shtrojmë guximshëm dhe pa u ndalur. Kolektivi ynë këtu për pak minuta do të orientoj në zgjidhjen e këtij problemi sa problematik aq edhe human por edhe largpamës. Ne sot kemi shumë shtresime edhe në Ballkan edhe etnike edhe kombëtare edhe politike dhe interesash të ndryshme sa që shumë entitete nuk e din ka t'ja mbajnë. Unë mendoj se akademik dhe institucionet shkencore në këtë drejtim duhet të jenë shumë të ndërgjegjshme aq më par kur në këtë drejtim mendoj dhe ju ftoj që me guxim të organizoheni ta ndani punën ti ndani funksionet dhe ti përgjigjeni vetëdijeve të sinqerta pa ekuivoqe pa urrejtje.

Nëse këtë e evitojmë që në fillim suksesi pa dyshim do të jetë fatlum dhe do të jetë faqebardhë, ashtu siç duam të gjithë. Për ta kuptuar këtë temë unë dua që t'ju drejtoj që në hulumtimet që duhet bërë shkencore nëpër arkiva. Mos mendoni në ato hulumtimet e mija sepse nuk kam mundur t'i hasi këto elemente në fonde shtetërore. Mos harxhoni kohë në fondet të cilat i kanë krijuar institucionet e shtetit por të orientoheni në të ashtuquajturat koleksione arkivore dhe konkret ku ta gjeni fillimin, një dritë në fund të tunelit. Do t'ju drejtoj me një sinqeritet më të madh që ta hulumtoni fondin e Milan Shudvaj një ndër njerëzit më të mëdhenj të

medievizmit dhe historisë në përgjithësi natyrisht duke u thirr edhe në literaturën që profesorët tanë më të vjetër kanë hulumtuar pak a shumë në këtë drejtim. Ju orientoj që të hulumtoni në arshivën e Stambollit fondin lenleshimes një ndër patriotët, shkencëtarët dhe politikanët më të mëdhenj shqiptar. Ali Shima ishte jo vetëm patriot por ishte njeriu më i gjallë nga penda në Perandorinë Osmane edhe pse ai në klubin e tij e shkruante Shqiptari dhe i turrte shqiptarët që të mos bëhen osmanli, mos të bëhen xhonturq, mos të bëhen diçka çka nuk janë por ta quajnë veten shqiptar. Edhe ju mos u turpëroni por më guxim mbanë këtë qëndrim dhe trashëgoni ashtu si duhet sepse vetëm në atë drejtim e tregoni dinjitetin e juaj edhe para civilizimit edhe para popullit edhe para zotit.

Përpos fondit të Ali Shimës ju udhëzoj që të hulumtoni edhe fondin e Nikol Ivanov fondi i të cilit gjendet në Cetinje, me kujdes, me seriozitet në fondin e tij do të gjeni shumë elemente shtresor të kombeve dhe të laramanive të ndryshme që ka pas jo vetëm kjo trevë por i terë Ballkani. Jo vetëm ky por hulumtojeni me kujdes punën e Sami Frashërit nga viti 1897-1898 për arsye se, në këtë periudhë, një ndër artistët më të mëdhenj siç ishte Dr. Vlladani u orientua që ti likuidoj të gjithë ata popuj që kanë orientime tjera dhe që nuk duan të mësojnë në gjuhën serbe. Mandej nuk është zor që ta hulumtoni fondin e njërit prej njerëzve më të ngarkuar me shovinizëm Jovan Hadjivasilevic sepse duhet të mësoni edhe prej atij që ju urren edhe prej atij që ju donë më shumë druani nga ai se nga ai që iu urren nëse organizoheni. Është një fond i Qamil Pashës në Stamboll, ky ka qenë edhe kryeministër, ai njeri kishte një orientim të gjerë, kishte një dituri të gjerë, ky njeri ka qenë ai më fatlumi që e ka njohur edhe Kemal Ataturkun një njeri shumë i madh por edhe Ali Shefqet Shkupin i cili u bë një ndër komandantët e parë të ushtrisë shqiptare që njeherit ishte edhe intelektual i shquar me gradë gjeneral që nga viti 1913 deri më 1953. duhet të ju them se duhet ta studioni edhe fondin e Jovan Ristic i cili ishte prezent në Kongresin e Berlinit për arsye se në vitin 1876 në Berlin u prezantua një hartë linguistike prej të cilës pastaj kanë dalë 12 harta linguistike shumë të mëdha por në të cilën janë sublimuar 24 harta linguistike të cilat flisnin për viset etnike shqiptare. Me këtë unë mendoj se do ta mbani në dorë një dritë dhe ajo dritë do të na ndihmoj shumë sepse rruga shkencore gjithmonë është e terravtë dhe në këtë drejtim të shkojmë përpara në drejtim të siç e keni venë aty me sinqeritet të madh “Egjiptiano-Shqiptar” dhe në atë rrugë nëse vazhdojmë kështu nuk ka asnjë forcë që na ndal.

## **Opinione dhe analiza mbi gjendjen e Egjiptianeve të Kosovës**



## **Xhevdet Neziraj**

### **Gjendja aktualeve e Egjiptianeve të Kosovës**

Sot në rrethanat në të cila gjendemi si bashkësi e vogël etnike në Kosovë ka vend për pakënaqësi nga ata të cilët na kanë dhënë besimin e përfaqësimit në institucione. Tani gjendemi në një situatë kur nuk ka qeverisje efektive nga ata që e drejtojnë qeverinë e vendit dhe ka një vazhdimësi të tejkalimit të kërkesave dhe nevojave të komunitetit egjiptian në Kosovë nga ana e institucioneve përgjegjëse. Unë si përfaqësues i egjiptianeve të Kosovës në Kuvendin e Kosovës nuk po hezitohet që t'i ngrihet çështjet të cilat kërkojnë zgjidhje adekuate nga ana e institucioneve të Kosovës.

Nga zhvillimet e fundit të rëndësishme është fillimi i komunikimit me njerëz të cilët priten që në të ardhmen të kenë rol të rëndësishëm në shtetin e Egjiptit. Lidhur me këtë çështje janë duke u bërë përpjekje të duhura për vendosjen e lidhjeve të qëndrueshme me Egjiptin në mënyrë që të fillohet me biseda për njohjen e egjiptianeve të Kosovës dhe më gjerë nga shteti i Egjiptit. Kështu jemi në kontakt me veprimtarin Egjiptian që pritet që të zhvillojnë vizita në Kosovë dhe të hulumtojnë më për se afërmi çështjen e Egjiptianeve në Kosovë dhe më gjerë në Ballkan.

Unë konsideroj se orientimi kryesor yni sot duhet të jetë zhvillimi i kontakteve me Egjiptin, pra shfrytëzimi i mundësisë së zhvillimeve të fundit në Egjipt në mënyrë që kontaktet me Egjiptin të jenë në nivel institucional dhe të punojnë për njohjen e egjiptianeve nga ana e Egjiptit. Përkujdesja e Egjiptit për neve në Ballkan do të ishte çelësi kryesor i hapjes së mundësisë për pozitë të duhur në shoqëritë ku jetojmë prandaj kërkohet nga të gjithë të cilët kanë mundësi që këto kontakte të intensifikohen dhe koordinohen në mënyrë që të rezultojnë të suksesshme.

Për fat të keq, pas nderjes së komunitetit tonë në Egjiptian dhe ashkali ndodhi edhe një përpjekje për ndarje ideologjike në mes të egjiptianeve përmes aventurave politike të disa njerëzve të pa ndërgjegjshëm

për gjendjen dhe të ardhmen e Egjiptianeve të Kosovës. Nuk ka dyshim se kjo ndarje u nxit nga individë të caktuar të cilët vetveten e identifikojnë si baba të kombit dhe që nuk kanë durim që t'i dëgjojnë dhe analizojnë të tjerët por vetëm vetveten.

Ne po morremi me këta njerëz por as populli nuk i dëgjoj këto demagogji e fjalor përçarës por ata kanë ditë të vlerësojnë se kush është i denjë që t'i përfaqësoj interesat e popullit dhe natyrisht i dhanë besimin. Njerëzit që dështuan në IRDK dhe që i dëgjuan apetitet e njerëzve politikisht të verbër ata u ndëshkuan. Ata që na ndanë në egjiptian e ashkali ata po merren me neve e jo me ashkalishtë e tyre që si pasojë e papërgjegjësisë të tyre gjatë veprimeve të para luftës njerëzit e frustruar dhe frikësuar e fshehën identitetin e tyre dhe u deklaruan si ashkali vetëm e vetëm që të mos identifikohen me ata individë.

Shumë po merremi se kush është baba i kombit, kush filloj i pari e kush i dyti, kush ka më shumë merita e kush më pak. Këto vlerësime duhet t'i bëjnë gjenerata që vijnë pas neve e jo ne vetë. Ne e shkruajmë historinë me veprimet tona ndërsa nuk kemi të drejtë edhe t'i vlerësojmë ato veprime, duhet t'ja lëmë dikujt tjetër.

Ne jemi të hapur për kritika dhe sugjerime e sidomos atëherë kur jepen alternativa por nuk jemi të gatshëm t'ju dëgjojmë fyerjet dhe sharjet e askujt.

Unë i përshëndes bashkëkombësit tonë në mërgatë, në Gjermani dhe Zvicër dhe në vende tjera dhe i falënderoj shumë për kontributin e tyre që e kanë dhënë deri më tani. Ne jemi në dijeni të formimit të strukturave të reja të organizimit të diasporës dhe në këtë rast iu uroj që këto struktura të jenë funksionale dhe sigurisht se bashkëpunimi i ndërsjellët nuk do të mungoj.

Ne jemi të vetëdijshëm se nuk gjendemi në pozitën e duhur dhe ballafaqohemi me vështirësi të cilat ne të gjithë duhet t'ju dalim përball dhe të ballafaqohemi me to prandaj iu bëj apel të gjithë bashkëkombësve të mijë që në të ardhmen të jemi më të sinqertë me vetveten duke e pranuar dhe promovuar identitetin tonë etnik, duke u koordinuar të gjithë faktorët e rëndësishëm që të punojmë për qëllime të përbashkëta, të rritet solidariteti në mes nesh duke i ndihmuar ata që duhet të ndihmohen nga ata që mund të ndihmojnë.

## **Fazli Stollaj**

### **Koha mund të na harroj për shkak të spontanitetit tonë**

“Me kohë do të mësohemi që të thërrasim vetveten Egjiptian!!”. Por sa e gjatë do të jetë kjo kohë dhe a është rrezik që koha të tretë këtë punë në spontanitetin e cili na ka kapluar, mbetet të shihet.

Të punosh për çështjen e identifikimit tonë si bashkësi e veçantë etnike në trevat e Ballkanit, duke dhënë atë çka ke mundësi, ndoshta behët mund por munda shpërblehet. Munda shpërblehet, jo me pare siç kanë dëshirë disa që kanë bërë mund, por në krenari dhe atë duke u krenuar se qëllimi është arrit. A është arrit qëllimi? Unë medoj se jo, bile them se nuk i kemi mirë punët për shkak se nuk e kemi të qartë se cili është caku.

Pas veprimtareve të etapës së parë të Egjiptianeve (1990-1999) vazhduan veprimtarët e etapës së dytë të mbledhur fillimisht rreth shoqatës “Shqiptaro Egjiptiane” e cila pasoj me partinë politike IRDK. Rreth këtyre subjekteve të organizuara ishte mbledhur elita e egjiptianeve të Kosovës të cilët jo me përvojë të madhe, me guxim modest dhe rrethana jo të përshtatshme të veprimit vazhduan mbrojtjen dhe avancimin e identitetit etnik të Egjiptianëve të Kosovës. Veprimtarët e etapës së dytë treguan një kompaktësi gjatë periudhës kur bashkëjetuan me shoqatën, ndërsa kompaktësia u zbeh atëherë kur filloj beteja për vendet e rezervuara. Përfaqësuesit politik të Egjiptianeve të Kosovës arritën që Egjiptianët e Kosovës të njihen si bashkësi etnike në Kushtetutën e Kosovës ashtu siç njihen edhe askalitet. Krahas përpjekjeve tjera për realizimin e të drejtave ligjore për Egjiptianët e Kosovës, njohja e Egjiptianeve si bashkësi etnike nga Kushtetuta e Kosovës është e arritura më e madhe për Egjiptianët e Kosovës në aspektin e procesit të ndërtimit të identitetit etnik. Veprimtarët e etapës së dytë arritën edhe të organizojnë një tribunë në Prishtinë me qarqet akademike të Kosovës nga e cila dolën argument të vlefshme mbi etnogjenezën tonë. Një mund i madh nga veprimtarët e etapës së dytë është bërë edhe në kundërshtimin e akronimit RAE formulë e zbuluar nga ndërkombëtarët e që ka zënë vend edhe të vendoret por edhe të shoqëria civile e Egjiptianeve të Kosovës. Tash kushtetuta na njih, disa të drejta të garantuara me ligj për bashkësitë etnike po realizohen e disa tjera nuk na ndalon askush që të kërkojmë që të realizohen. Nuk duhet pritur që të drejtat tona do të real-

izohen në idealisht sepse gjithmonë do të ketë pakënaqësi. Atëherë ku qendron problem jonë?

Problemi me të cilin nuk po merremi aspak dhe 'a kemi lenë spontanitetit është problemi i (mos)njohjes se vetvetes. Gati askush nga ne gjatë bisedave që i bëjmë me fëmijët dhe anëtarët e tjerë të familjes nuk e përdorin fjalën egjiptian por gjithmonë e përdorim fjalën magjup. Askush nga ne nëpër tubime qoftë gazmende ose takime mortore që zgjasin me nga tri ditë e më shumë nuk e identifikojmë veten si egjiptian por si magjup ose si "dora jonë". Gati askush nga ne kur kemi rast të bisedojmë me etni tjera nuk merr guximin të thotë "ne egjiptianet" por mundohet të fsheh vetveten ose nëse nuk arrin identifikohet si magjup ose "dora jonë".

Nuk ka dyshim se pothuajse asnjëri nga pjesëtarët e Egjiptianëve të Kosovës nuk e mohan origjinën nga Egjipti dhe gjithkush do të ketë telashe me këta nëse dikush i quan rom. Atëherë ku është problem i mos identifikimit të vetvetes si Egjiptian?

Duhet pranuar faktin se ky emërtim i vetvetes po rezistohet nga vetvetja për disa arsye. Në radhë të parë, është një pikëzim që i kemi bërë vetvetes jo më shumë se 20 vite ndërsa në periudha të caktuara të këtyre viteve ky emërtim edhe është politizuar dhe është pranuar nga masa si identifikim politik e jo etnik. Gjithashtu emërtimi i vetvetes me emërtimin e njëjtë me Egjiptianët e Egjiptit në momentin e parë tingëllon si paradoksale për shkak të largësisë gjeografike me Egjiptin dhe për shkak të mos njohjes së gjuhës egjiptiane.

Temperamenti i theksuar i secilit pjesëtarë të Egjiptianeve të Kosovës në rast të identifikimit si rom është ana jonë e fortë dhe shpresëdhënëse për elitën e egjiptianeve në trevat e Ballkanit për të hapur debat të shëndosh lidhur me pranimin e vetvetes. Gjithashtu është shumë e nevojshme që të zbutën barrierat e krijuara me ashkalitë dhe të arrihet një pajtim se të gjithë jemi me origjinë nga Egjipti pa marrë parasysh emërtimet për vetveten. Elita e Egjiptianeve duhet të marrë iniciativën për biseda në mes të ashkalive dhe egjiptianeve në Kosovë për arritjen e pajtuesmerisë lidhur me etnogenezën e tyre. Këtë iniciativë nuk duhet pritur nga klasa politike sepse kjo nuk do të arrihet asnjëherë për shkak të rrezikimit të pozitave të rezervuara për këto komunitete në Parlamentin e Kosovës.

Këto probleme duhet të trajtohen e mos t'i mbeten kohës sepse rrezikohet që koha mund t'ia dorëzoj spontanitetit tonë vetë po e kultivojmë.



## **Imer Alijaj**

### **Apel intelektualeve**

Pasivitet do të thotë t'ia kthesh shpinën problemeve, e kjo është dukuri e dëmshme si për individin, ashtu edhe për shoqërinë njerëzore. Në mjerimin tonë të tanishëm nuk kemi të drejtë të lavdërohem me famën e dikurshme, por ne duhet të kuptojmë se neglizhenca, pasiviteti dhe përtacia jonë e ka shkaktuar dekadencën tonë të tanishme e jo ndonjë e mëtej. Ne intelektualët nuk duhet të jemi pengesë e progresit, punës etj. Aktiviteti i intelektualëve edhe nga feja Islame çmohet gjerë në atë shkallë sa që ato(aktivitetet) i vë mbi Engjuj. Përtacia dhe pasiviteti janë pengesë e progresit njerëzor të një shoqërie prandaj ekziston një motiv që të flitet për bashkimin dhe unitetin e popullit tone sidomos i intelektualëve tonë.

Populli jonë po kalon nëpër një fazë të dëshpërimit dhe të nervozes, humbjes së identitetit të vetë, humbjeve materiale, sociale, ekonomike etj. Përparimi dhe zhvillimi jonë kërkon vendosjen e bashkimit e të gjithëve pa përjashtim sepse bashkimi është mishërim e personifikim e gjithëçkajit që është e mirë dhe fisnike. Bashkimi është kriter civilizues i përparimit të popullit sepse e forcon fisnikërinë, dinjitetin dhe sovranitetin e tyre. Përveç kësaj, bashkimi është bërë nevojë ekonomike, politike, sociale dhe kulturore. Pos kësaj rrjedha e historisë

botërore nxit ekzistimin e asociacioneve të mëdha siç janë OKB, OSCE, UNHCR etj. që të merret me këtë popull.

Suksesi në këtë punë kërkon udhëheqje, urtësi, dituri qellim të mirë dhe sigurim të rrethanave të volitshme të brendshme dhe të jashtme, që realisht mund të zgjasë gjatë. Qëllimi im është vendosja e themeleve të mënyrës së jetesës nacionale. Duhet të kemi një vizion të plotë civilizues për të tashmen dhe të ardhmen tonë që do ta bëjmë së bashku. Mungesa e këtij vizioni nga sfera e politikës, shoqërisë, mendimit dhe kulturës e paralizon çdo aktivitet dhe përpjekje që ka të bëjë me çështjen tonë. Andaj ekzistimi i vizionit i cili e analizon të tashmen dhe e ndërton të ardhmen paraqet domosdoshmëri për ta kuptuar aktualitetin dhe zbulimin e asaj që sjell ardhmëria. Para neve qëndron një punë e madhe, përndryshe do të mbesim në margjinë të ngjarjeve duke i imituar dhe duke u mbështetur të tjerët.

# Foto galeria























Vitin e kaluar para Shtëpisë së Kulturës në Klinë u sollën dy monumente epigrafike prej guri, ku gjenden edhe sot. Fjala është për dy ekzemplare mjaft të vlefshëm të dy llojeve të ndryshme monumentesh nga periudha e sundimit romak, por që tani janë të rrezikuar seriozisht...

PROF. DR. NASER FERRI

Qatë viti që shkojë nga fshati Dresnik u bartën në Klinë dy monumente antike dhe asokohe u vendosen para Shtëpisë së Kulturës 'Jehona e Dukagjinit', ku gjenden edhe sot e kësaj dite. Fjala është për dy monumente të dy llojeve karakteristike (mbivarrure dhe perkushtimorë) që kanë rëndësi të veçantë për njohjen e së kulturës së kësaj treve.

Monumenti i parë është monument mbivarrur, respektivisht është një stelë antike prej mermeri të bardhë me dimensione 144 X 76 X 23 cm dhe që i mungon pjesa e epërme dhe është i thyer përgjysmë. Është zbuluar në cerekun e parë të shekullit XX, në fshatin Dresnik, brenda relikteve të kishtës së lashtë. Nga stela është ruajtur fusha mbishkrimore, e cila është dekoruar me hardhi rrushi që del nga një enë me dy vegë, ndërsa i mungon pjesa e epërme, respektivisht edukula, në të cilën pa dyshim duhet të kishin qenë paraqitjet e të aderjeve, si dhe cepi i poshtëm i anës së djathtë. Teksti në fushën mbishkrimore, i shkruar në gjuhë latine, është ruajtur ai vijon:

D MVALENS TIME/IS ANX XXX/SIB/ ET CIVIT/

NI SVAE SPER/SITTI BMP/ Lartësia e shkronjave është 5-6 cm. Nga tek-

sti i mbishkrimit kuptojmë se stelen e kishte ngritur Valens Timentis (jetoi 35 vite) për vetë dhe për gruan me emrin Citia, e cila e kishte jetuar më gjatë. Emri i gjinisë femërore Citia nuk është i njohur menjëherë dhe konsiderohet vendës, si edhe emri mushkullor Timens, i cili konsiderohet ilir, kurse emri latin Valens tojen anasidite, i në që kemi të bëjmë me një vendës, i cili kishte pranuar disa nga elementet onomastike latine.

### Një ekzemplar i rrallë

Monumenti tjetër është një altar prej mermeri të bardhë, i punuar dhe i profiluar nga tri anët me dimensionet 104 X 49 X 40 cm. Altari është ruajtur tej merrë dhe ka kapitelin, trupin me fushë mbishkrimore dhe bazamentin, të gjitha këto, pos mbishkrimit, thuhet të padëmtuara. Në kapital është dekorimi i përbër nga dy palmeta anash dhe një rozetë tej interesante në mes të tyre, ndërsa nga fusha mbishkrimore është shlyer mbishkrimi. Sipas shënimeve, ky altar është gjetur po ashtu në Dresnik, në të njëjtin vend ku është gjetur edhe stela. Teksti i mbishkrimit të tij ka qenë shumë i shkurtër dhe përmante vetëm perkushtimin: SERAPI INVICTO, pa kurrfarë të dhënash të tjera. Në fund, në mbishkrim, e kishte një gjehe urthi në formë zerre, që tek mbishkrimet antike latine zakonisht përdoretin si shenja ndarëse mes fjalëve (hedera distinguentes). Nga teksti mund të kuptohet se altari i që perkushtuar hyjt Serapis, i cili këtu bart epitelin Invictus i pamposhtur, i pathyeshëm). Por, nga teksti i mbishkrimit nuk mund të kuptohet se kush ishte dedikuar, çfarë ishte ai me profesion etj. Siç është rasti edhe tek mbishkrimi nga Lukaveci i Thatë. Madje, në të dy rastet, mungojnë edhe formulat standard epigrafike, me të cilat mbaheshin tekstet e këtitë.

Serapis ishte perëndi sinkretike greko-egjiptase nga periudha e pushtetit të sundimit egjiptas me origjinë greke Ptolemeus I (304-282) dhe u krijua si rezultat i lidhjeve tregtare dhe kulturore ndërmjet Greqisë dhe Egjiptit dhe, si i tillë, simbolizonte sintezën e kulturës greko-egjiptase. Ishte hyj i Diellit, i pleshmërisë, i shërimit dhe i mjekësisë, dhe po ashtu ishte hyj i detit dhe mbrojtës i marinarëve. Në aspektin ikonografik paraqitet me mjekër dhe kapelë karakteristike, të quajtur kalathos, e cila kishte formën piramidale. Si perëndi greko-egjiptase, ai i bartte atribuotet e kombinuar të perëndive greke Zeusit, Hadit, Asklepit dhe të hyjtë egjiptas Osiris, ndërkohë që disa vise ai ishte identifikuar me perënditë e përmendura. Anembësë Perandorisë Romake janë zbuluar mjaft monumente epigrafike të kushtuara Serapisit, ndërsa nëpër territoret e banuara nga dardanët, gjatë antikës, monumentet e këtitë janë mjaft të rralla. Në të vërtetë, pos këtyrë rastit, janë gjetur vetëm edhe disa monumente në jug të territorit të ish mbretërisë dardane në Zllakuqan afër Shkupit dhe në Lukavec i Thatë të Istogut, ndërsa në vitin 2003 u zbulua një altar i kushtuar Serapisit edhe në fshatin Zllakuqan, rreth 10-12 kilometra

është i vetmi rast i këtitë; i njohur deri më tash.

### Oazë e kulteve egjiptiane

Duke marrë parasysh faktin që zbulimet e monumenteve të kushtuara Serapisit janë të koncentruara vetëm në pjesën jugore të trojeve dardane, është shumë afër mendës mundësia që kult i Serapisit, permes territorit të Scupit antik, ka arritur në territorin e Kosovës nga Stobi ose vendbanimet tjera maqedonase, që ishin qendra të ndërmitt të kulteve egjiptase. Ndërkaq, tempulli më i vëndësishëm i ngritur për nder të Serapisit gjendet në qytetin egjiptas Alexandria dhe, kur perandori religjioz romak Theodosi I (379-395) i nxorri nga patriku fanatik Theofilos zyrtarisht i shkoloi ndërmim e kulteve pagane dhe e shkëlqëroi këtë tempull në vitin 391, ku ngjarje edhe u bë simbol i zhdukjes zyrtare të paganizmit nga Perandoria Romake.

Po kultit të Serapisit, në Zllakuqan janë zbuluar edhe gjurmët e ndërmitt të kultit të hyjneshmë me origjinë po ashtu egjiptase Isis, një që e karakterizon këtë treve wrroditë të kulteve egjiptase në këtë pjesë të Dardanisë. Isis ose Izida, emrin e të cilës u gjejmë në variante të ndryshme, ishte perendeshë egjiptase. Nën e Madhe Hyjrore dhe simbol i gruas së idealizuar. Sipas mitologjisë egjiptase, ajo ishte e bija e Tokës (Geb) dhe e Qullit (Nut). Njëkohësisht ishte motra dhe bashkëshortja e Osirisit dhe e öma e Horusit, dhe besohet se paraqitja e saj figurale me Horusin e vogël në prehrë u bë model i pikturive dhe skulptoreve mejetare për variantet e ndryshme të paraqitjes së Zojis së Bekuar me Kishinë e vogël. Zhulimet arkeologjike në Zllakuqan lejojnë mundësinë që aty kishte ekzistuar një faltore, ku ndërroheshin kultet e hyjnive egjiptase.

Pa okupim të këtyrë trojeve, allavët e kishin përvetësuar altarit si dhe kishizën, në themetet e së cilës është gjetur ai, dhe, pasi e kishin shlyer mbishkrimin me datë, e kishin vu para hyrjes së kishtës, tashmë të riuvertur në Sveta Petka (Paraskëva), dhe mbi të kanë ndëzuar qirin. Që të dy këto monumente ishin zbuluar në doçimet e para të shekullit kaluar, ndërsa Nikolla Vulji i publikoi në vitin 1948, pa analiza të detajuar dhe vetëm me informata elementare. Stela, ndërkaq, kishte pasur një histori mjaft interesante, meqë Vulji asokohe shkruan se ajo ishte e shpëtur në Dresnik dhe pastaj ishte transferuar dhe vendosur në oborrin e shkolës fillore në Pejë, dhe me vonë, si duket, nuk e kemi të njohur kur dhe në çmënyrë është rivendosur në Dresnik, prej nga është bartur në Klinë.

Gjenja monumentale e monumenteve të përmendura është alarmante, meqë altarit gjendet i futur në një akhtë që nuk përçorot, afër hyrjes së ndërtesës, ndërsa stela është shtrire pertokë dhe bërë faqun e këtitë, femijet dhe shkollë kalimtare. Do të ishte një gjë e mirë, po të se syrtarët komunalë e një gjë e mirë, po të se nuk mjafton që monumente faktike në Klinë, por që atyre i mentet të sijnë në Klinë, por që atyre i nevojitet edhe tretmani adekuat mbrojtës dhe vendi dogë për ekspozitën. Meqë, siç dhe vendi dogë për ekspozitën përkatëse dihet, Klinë nuk ka institucione përkatëse që meren me punë, me mbrojtjen të këtitë.



Stela nga Dresniku

